

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 260, Qershor 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Viti 2025, 100-vjetorit të lindjes së Albanologut Martin Camaj "Nderi i Kombit" dhe "Qytetar Nderi" i qytetit të Shkodrës



Panairi i parë i librit "Libri të ban të lirë"

Në datat 5, 6 e 7 qershor 2025, në Famullinë "Zoja e Shkodrës" në ambientet e saj, në Sallën "Kardinal Mikel Koliqi", në Bibliotekën "Zoja e Shkodrës", në Amfiteatrin e Panairit, u zhvillua një veprimtari letrar, artistik, panair librash, diskutime dhe promovime librash nga Shtëpitë Botuese ma në za që kemi sot, "Fioretina", "Shkodra" e "Volaj".



Një denoncim ndërkombëtar i guximshëm ndaj krimeve serbe kundër popullatës në Kosovë

Përshëndetje Prof. Luljeta Pula!

E lexova me shumë vëmendje librin tuaj për helmimin e fëmijëve në Kosovë në vitin 1990, me titullin "Helmimet, Krimi dhe Mashtrimi". Është një punë shumë e madhe dhe me një përkushtim të jashtëzakonshëm, siç keni ditur Ju gjithmonë të punoni në vijën e parë të mbrojtjes së shtetave kombëtare të vendit.



Roli i prindërimit në forcimin e themeleve shpirtërore të kombit

Në një atmosferë të ngrohtë dhe frymëzuese, në qytetin e Shkodrës u zhvillua një ngjarje e veçantë me rastin e Ditës Globale të Prindërimit. Më 3 qershor 2025, Federata e Paqes Universale (FPU) në bashkëpunim me Këshillin Rajonal të Paqes Shkodër organizuan një veprimtari, me temë: "Roli i prindërimit në forcimin e themeleve shpirtërore të kombit". Kjo veprimtari, theksoi rëndësinë e familjes si një strukturë thelbësore për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të harmonizuar, duke vënë në qendër të vëmendjes prindërimin si një mision njerëzor dhe shpirtëror në shërbim të kombit.



U promovua në Shkodër libri i Maximilian Lambertz "Drama në Teatrin Shqiptar (1950-1963)"

- NJË DËSHMI E VONUAR ME VLERË HISTORIKE DHE KULTURORE -
Shkodër, 5 qershor 2024 — Në ambientet e Teatrit "Migjeni" u zhvillua një veprimtari kulturor me rëndësi të veçantë: Promovimi i librit "Drama në Teatrin Shqiptar (1950-1963)" nga albanologu i njohur Maximilian Lambertz, tashmë i përkthyer në shqip. Ky botim hedh dritë mbi zhvillimet e dramës dhe teatrit shqiptar në një periudhë të rëndësishme historike, të përshkruar me mjeshtëri nga një prej studiuesve më të njohur të gjuhësisë dhe kulturës shqiptare.

Roli i prindërimit në forcimin e themeleve shpirtërore të kombit

Në një atmosferë të ngrohtë dhe frymëzuese, në qytetin e Shkodrës u zhvillua një ngjarje e veçantë me rastin e Ditës Globale të Prindërimit. Më 3 qershor 2025, Federata e Paqes Universale (FPU) në bashkëpunim me Këshillin Rajonal të Paqes Shkodër organizuan një veprimtari, me temë: “Roli i prindërimit në forcimin e themeleve shpirtërore të kombit”. Kjo veprimtari, theksoi rëndësinë e familjes si një strukturë thelbësore për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të harmonizuar, duke vënë në qendër të vëmendjes prindërimin si një mision njerëzor dhe shpirtëror në shërbim të kombit.

Rreth 90 pjesëmarrës - Ambasadorë për Paqe, figura publike, të rinj dhe të ftuar të veçantë - morën pjesë në një atmosferë të ngrohtë dhe frymëzuese.

Drejtimin e veprimtarisë e realizoi me shumë profesionalizëm, Kryetarja e Këshillit Rajonal të Paqes Shkodër, znj. Majlinda Laçaj

Veprimtarinë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre, figura të njohura dhe respektuara nga Shqipëria, Kosova dhe Evropa, të cilët me fjalët e tyre përshëndetëse përcolën mesazhe të thella për rëndësinë e edukimit familjar, përgjegjësisë prindërore dhe paqes sociale.

Nderuan veprimtarinë:

Z. Alfred Moisiu, ish-President i Republikës së Shqipërisë

Z. Fatmir Sejdiu, ish-President i Republikës së Kosovës

Z. Jacques Marion, President i FPU për Evropën dhe Lindjen e Mesme

Z. Defrim Methasani, Kryetar i FPU Shqipëri

Z. Ali Laçej, Koordinator i Këshillit Mbarëkombëtar të Paqes

Z. Gani Rroshi, Sekretar i Përgjithshëm i FPU Shqipëri, i cili mbajti një fjalim përmbledhës mbi misionin e organizatës dhe veprimtarinë e saj në promovimin e paqes. Ai nënvizoi rëndësinë e familjes si baza më e sigurt për ndërtimin e një bote të drejtë dhe paqësore, duke theksuar se paqja nuk është një qëllim abstrakt, por një realitet që lind në zemrën e familjes.

Programi artistik i organizuar gjatë veprimtarisë i dha një tjetër dimension emocional dhe shpirtëror ngjarjes.

Maestro Anton Kaftalli krijoi një atmosferë të veçantë me tingujt magjepsës të violinës, ndërsa Denata Rroji preku zemrat e të pranishmëve me interpretimin e ndërë të poezisë “Porosia e babës”.

Të rinjtë e CARP Shkodër sollën energji, shpresë dhe entuziazëm përmes një performance, që përçoi mesazhe të qarta për rëndësinë e paqes dhe harmonisë.

Një nga momentet më domethënëse të kësaj veprimtarie ishte ndarja e titullit “Ambasador për Paqe” për 10 personalitete të shquara të qytetit të Shkodrës. Ky vlerësim u dha për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në promovimin e vlerave njerëzore, familjare dhe në bashkësi.

Z. Gjokë Vata

Znj. Tamara Gaci



- Z. Primo Shllaku
- Z. Vinçens Marku
- Z. Anton Shkoza
- Znj. Kristina Dema
- Znj. Elsidë Sina
- Znj. Denata Rroji
- Z. Tonin Binoshaj
- Z. Edis Kadia

E ardhmja e kombit tonë është në duart e emijëve tanë, dhe e ardhmja e fëmijëve tanë, është në duart tona, kur familja, bashkësia dhe institucionet bashkëpunojnë, mund të ndërtohet një e ardhme më e ndritur për brezat që vijnë,

Paqja nis në familje — aty ku lind shpresa për një të ardhme më të mirë!

Përgatiti MAJLINDA LAÇAJ
Kryetare e Këshillit Rajonal të Paqes Shkodër
Qershor, 2025



Panairi i parë i librit “Libri të ban të lirë”



Në datat 5, 6 e 7 qershor 2025, në Famullinë “Zoja e Shkodrës” në ambientet e saj, në Sallën “Kardinal Mikel Koliqi”, në Bibliotekën “Zoja e Shkodrës”, në Amfiteatrin e Panairit, u zhvillua një veprimtari letrar, artistik, panair librash, diskutime dhe promovime librash nga Shtëpitë Botuese ma në za që kemi sot, “Fioretina”, “Shkodra” e “Volaj”.

Shkodra e historisë së shtëpive botuese ma të vjetra në Shqipëri si, “Tipografia e Zojës së Papërlyeme” në Shkodër (1870-1945), Shtypshkronja “Nikaj” (1909), Shtypshkronja e Etërve Françeskan (1916) e të tjera, po bënte Panairin e parë të librit në brendësinë e ambienteve të jashtme të Kishës së Madhe, ndoshta rasti unik në vendin tonë, por edhe kundtjetër.

Tek i vizitoja disi kalimthi stendat e Panairit për të parë librat dhe autorët e tyre, më binte në mendje se bash aty te ato stenda, dikur e një kohë, kalonin atypari, shkrimtarët dioqezan si Monsinjon Ernesto Çoba, Imzot Luigj Bumçi, D. Lazër Shantoja, D. Mikel Koliqi, D. Lazër Gurakuqi, D. Ndre Mjedja, D. Ndre Zadeja, e sa të tjerë të madhërisëm, dhe i përfytyroja me anën e Inteligjencës Artificiale në mendje, tek soditnin stendat te ai oborr i madh i Katedrales “Shën Shtjefni”.

Kisha e Madhe, objekti më ikonik dhe më i madh i botës katolike në vendin tonë, ka vite që është hapur për popullin e Shkodrës, i cili i viziton dhe i kundron ambientet kreative të saj, aty është Salla e madhe dhe e bukur “Kardinal Mikel Koliqi”, Biblioteka “Zoja e Shkodrës”, ndoshta dhe pa diskutim, më e bukura, më modernia në vendin tonë, Muzeu Dioqezan, këndë lojërash për të ri e të reja, një lulishte e bukur e gjelbëron dhe e hijeshon të gjithë ambientin përreth kishës.

E, në këto mjedise, jo fetare, populli i Shkodrës, miq e të ftuar morën pjesë në Panairin me emrin më sinjifikativ “Libri të ban të lirë”.

Tre ditë, të paharruar për shumëkënd, për organizatorët, shkrimtarët, lexuesit, popullin dhe qytetin.

Ku mund të jetë më i lirë, libri dhe pop-



ulli sesa pranë Kishës. Duke qenë prezent në lexime dhe diskutime, disa herë më vinte në mendje lutja apostolike “URBI ET ORBI”, në kuptimin Urbi - qyteti dhe njerziti dhe, Orbi - bota e librit, a nuk është libri, bota në duart tona?!

U shitën libra, u ndanë çmimet, u përshëndeten të gjithë pjesëmarrësit me urimin legjitim: Shkodra duhet ta ketë Panairin të përvitëshëm, ndoshta edhe në mjedise të tjera, por aty ku u zhvillua sivjet, janë kushte optimale, dhe vend i ëmbël estetikisht.

Vini oroe!

Libri, e dëshmojnë të gjithë, po kalon në një krizë, sidomos, për lexuesin e tij, jeta eterike, smartfonët dhe teknologjia po bën namin. Librat shtypen me tirazh të vogël, shtëpitë botuese dhe shtypshkronjat, për të justifikuar Çmimin dhe humbjet financiare, po na japin libra të trashë, me kopertona të renda, bie fjala, librat që unë bleva, i peshova në shtëpi dhe peshorja më dha 7,4-kilogram libra!!!

Buxheti?, - ec e merre me mend!

Më mirë do bahet, pa libra nuk çohet jeta!

Me kete rast u promovua libri studimore “ARBËRESHËT” - Shqiptarët e Italisë, të autorit Fatmir Toçi.

Në këtë veprimtari ishin të pranishëm intelektualë të shumtë, krijues e lexues të pasionuar të letërsisë, artistë e aktorë, përfaqësues të pushtetit lokal e të tjerë.


Fjalën kryesore në këtë promovim e mbajti intelektual, krijuesi e përkthyesi i talentuar, Kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve Shkodër z. Zija Vukaj.

Me këtë rast morën fjalën e shprehën vlerësimet e tyre për këtë veper letrare studimore edhe personalitete të tjera të letrave shqipe .

Autori Fatmir Toçi prezantoi përmbajtjen e punën për realizimin e këtij libri voluminoz, me shumë hulumtime e shfletime në arkiva Kombëtare e Ndërkombëtare.

Kjo ishte një veprimtari mirë përgatitur, mirë organizuar nga Kryetari i shoqatës se Shkrimtareve në Shkodër, z. Zija Vukaj dhe shumë e vlerësuar nga pjesëmarrësit.

LEONAED QYTEZA,
Shkodër, me 9 qershor 2025



U promovua në Shkodër libri i Maximilian Lambertz “Drama në Teatrin Shqiptar (1950-1963)”

- NJË DËSHMI E VONUAR ME VLERË HISTORIKE DHE KULTURORE -

Shkodër, 5 qershor 2024 — Në ambientet e Teatrit “Migjeni” u zhvillua një veprimtari kulturor me rëndësi të veçantë: Promovimi i librit “Drama në Teatrin Shqiptar (1950-1963)” nga albanologu i njohur Maximilian Lambertz, tashmë i përkthyer në shqip.

Ky botim hedh dritë mbi zhvillimet e dramës dhe teatrit shqiptar në një periudhë të rëndësishme historike, të përshkruar me mjeshtëri nga një prej studiuesve më të njohur të gjuhësisë dhe kulturës shqiptare.

Jetëshkrimi i shkurtër për Maksimilian Lambertz

Maksimilian Lambertz (1882-1963) ishte një gjuhëtar, filolog dhe albanolog austriak, me kontribute të jashtëzakonshme në studimin e gjuhës, letërsisë dhe folklorit shqiptar. Ai studioi për gjuhësi krahasuese dhe filologji klasike në Vjenë dhe mbrojti doktoratën me një temë mbi emrat e skllëverve grekë.

Pas një udhëtimi në Greqi ku u njoh me dialektin arvanitas, Lambertz u pasionua për shqipen dhe iu përkushtua albanologjisë. Ai botoi librin e parë për mësimin e shqipes në vitin 1913 dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, mori pjesë në ekspedita shkencore në Shqipëri, që mbledhi materiale të pasura për gjuhën dhe kulturën popullore. U bë anëtar i parë i huaj i Komisionit Letrar për gjuhën shqipe.

Në vitet pasuese, dha mësim në Austri dhe më pas në Leipzig të Gjermanisë Lindore, ku vijoi studimet mbi gjuhët ballkanike. Vizitoi disa herë Shqipërinë pas vitit 1950 dhe ruajti gjithmonë interesin për folklorin dhe teatrin shqiptar.

Përkthimi i veprës së Gjergj Fishtës “Luta e maleve” në gjermanisht, është një ndër arritjet e tij të veçanta.

Lambertz u nda nga jeta në vitin 1963 dhe u varros në Vjenë. Ai mbetet një ndër figurat më të rëndësishme të albanologjisë evropiane.

Një dorëshkrim i fshehur për dekada

Libri përmban analizat e Lambertz mbi zhvillimin e dramaturgjisë shqiptare në vitet 1950-1963, të bazuara në vizitat e tij në Shqipëri dhe vëzhgimet në skenat teatrore të kohës. Megjithatë, ky material nuk u publikua kurrë në kohën kur u dorëzua (1967), ndonëse u përkthye në shqip nga Daniel Radiqi. Sipas një raporti të brendshëm të asaj kohe, i hartuar nga prof. Androkli Kostallari (1968), vendimi për mos botimin e dorëshkrimit u arsyetua me faktin se:

* Në të përmenden autorë dhe vepra, të cilët nuk përfaqësojnë nivelin e duhur ideologjik ose estetik.

* Janë përfshirë analiza të dramatikes, që nuk kishin njohje ose sukses në teatrot shqiptare.



Disa vepra përmbanin vlerësime, që nuk përputheshin me vijën zyrtare kulturore të kohës.

• Përmendeshin autorë, të cilët nuk duhej të përfshiheshin në publikime zyrtare.

Për më tepër, në raport theksohej se rreth 1/3 e librit do të duhej të hiqej përpara çdo botimi, çka e bënte procesin e publikimit të pamundur në kushtet e atëhershme.

Rikthimi pas dekadash i një dëshmie me vlerë

Botimi i librit u bë i mundur falë përpjekjeve të shkrimtarit Stefan Çapaliku dhe Konsullatës së Nderit të Austrisë në Shkodër, nën drejtimin e z. Frano Kulli, të cilët punuan për rikthimin në vëmendje të këtij materiali historik.

Në fjalën e tij përshëndetëse, z. Kulli theksoi vlerën dokumentare dhe kulturore të dorëshkrimit, si dhe rëndësinë e përshkrimeve të sakta që Lambertz jep për teatrin shqiptar dhe figurat pak të njohura të tij si Ton Shoshi, Zef Pali, Gjon Daka, apo Kin Dushi.

Një homazh për një mik të madh të shqiptarëve

Lambertz, një prej përfaqësuesve të fundit të plejadës së albanologëve austro-hungarezë, ka qenë një mik i madh i kulturës shqiptare.

Ky libër përbën një dëshmi autentike e vlerësimeve të tij për teatrin dhe dramaturgjinë shqiptare në një periudhë të

vështirë, por vendimtare, për formësimin e identitetit kulturor kombëtar.

Veprimtaria u përmyll me falënder-



ime për të gjithë bashkëpunëtorët që bënë të mundur botimin dhe promovimin e librit, përfshirë Bashkinë Shkodër, Drejtorinë e Kulturës dhe Teatrin “Migjeni”.

Fjala e plote e Konsullit të nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, z. Gjergj Leqejza

Të nderuar miq, që na keni nderue me pjesëmarrjen tuaj!

Sot po promovojmë librin “Drama në Teatrin Shqiptar (1950-1963)” të Albanologut Maximilian Lambertz, mikut të shquem të Shqiptarëve, i cili së bashku me shkencëtarët Austro-Hungarezë e Austriake të sotëm si Miklosich, Gustav Mayer, Jirecek, Sufflay, Patsch, Jokli, Noptza, Haberland, Nachtingall... e të tjerë e të tjerë, bëri aq shumë për mbledhjen, sistemimin e promovimin e trashëgimisë kulturore e jo vetëm, në trevat shqipfolëse.

Ky botim, i cili është pjesë e projekteve të Konsullatës së Nderit të Republikës së Austrisë, në Shkodër, të cilën kam nderin e përgjegjësinë e veçantë ta drejtoj tash 21 vjet, asht rrjedhojë e një propozimi shumë interesant, që shkrimtari Stefan Çapaliku me bani para disa kohesh, duke më përshkrua një material (ditar) me shënime të Maximilian Lambertz, të mbajtur gjatë vizitës së tij në Shqipëri, në vitet 1950-1960 e në të cilin asht pasqyrua në mënyrë të detajuar e me profesionalitet gjendja e zhvillimi i Dramës në Teatrin Shqiptar.

Ketë material në gjermanisht e veja e Maximilian Lambertz (Jozefa) ja dër-

gon Universitetit Shtetnor të Tiranës të asaj kohe e personalisht Prof. Androkli Kostallari, në vitin 1967, material i cili megjithëse mbante emnin e të madhit Lambertz si një nga më të mëdhenjtë e ndoshta i fundit i plejadës së Albanologëve Austro-Hungarezë e Austriake dhe ishte me shumë vlere për nga përmbajtja e cilësia e analizës, nuk u botua kurrë...megjithëse fatmirësisht u përkthye në shqip prej Daniel Radiqit. Kjo me drejte e ka intrigue Stefanin e padyshim edhe mue dhe menjëherë ramë dakord, që të bashkëpunojmë për të ba të mundur botimin e këtij materiali interesant dhe faleminderes Zotit, sot po e promovojmë.

Tuj lexue librin vëhet re një precizion në përshkrimin e vlerësimit e zhvillimit të zhanrit të Dramës në Teatrin Shqiptar tuj ba komente profesionale për tekstet, përmbajtjen, mesazhet, gjuhën e perdorun, lojën e aktoreve e nivelin e regjisorëve për te të cilat padyshim do të flasin autori e bashkëpunëtorët e tij, mendoj se ka shumë vlere edhe përshkrimi e paraqitja e personave krijues dhe e aktoreve të panjohun apo shumë pak të njohun si Ton Shoshi, Zef Pali, Tefe Pali, Gjon Daka, Kin Dushi e të tjerë dhe në të njëjtën kohë vlerësimi për shkrimtarët e dramaturget e njohun si Kole Jakova, Jonuz Dini, Bedri Dedja, Ndreke Luca, Andrea Skanjeti, Lec Shllaku, Preng Lekunda e të tjerë

Në mbyllje te fjalës teme, gjej rastin të falënderoj përzemërsisht të gjithë ato e ata, që bashkëpunuan e bane të mundun botimin e promovimin e këtij libri tuj fil-lue me Autorin e bashkëpunëtorët e tij si dhe botuesin mikun tim, Frano Kulli.

Nji falënderim i veçantë shkon për Bashkinë Shkodër, me Kryetarin e saj, z. Benet Beci, Drejtorinë e Kulturës, me drejtuesit e saj, Teatrin “Migjeni”, pa të cilët nuk do të kishim pase mundësi me realizue ketë promovim në nivelin që i takon për çka përfaqëson ky libër.

Dhe në fund, jo për nga rendisja, nji falënderim i përzemërt për të gjithë ju, që keni gjet kohen me kenë prezent .

Faleminderes!

Përgatiti JONA LEQEJZA

Poeti - Major Çesk Lukani

Promovimi i dy librave të poetit - Major Çesk Lukani - Një mbrëmje e ndjeshmërisë dhe vlerës kulturore Qendra Rinore "Atelie" - Shkodër, 12 mars 2025

Në datën 12 mars 2025, në Qendrën Rinore "Atelie" në Shkodër, u zhvillua me sukses promovimi i dy librave poetikë të autorit - Major Çesk Lukani: "Lutje Hënës" dhe "Me zemër shkrova". Veprimtaria u organizua nga Shoqata e Shkrimtarëve të Shkodrës dhe u drejtua, me klas dhe profesionalizëm nga Senada Demushi : poete, studiuese, drejtuese shkolle dhe prezantuese e përkushtuar.

Pjesëmarrja ishte e gjerë dhe përfaqësuese, në cilën u përfshinë emra të njohur të artit dhe shkollimit, përfaqësues të shoqatave të ndryshme dhe dashamirës të fjalës së bukur.

Në promovimin e këtyre dy vëllimeve morën pjesë anëtarë të Shoqatës së Shkrimtarëve Shkodër, Anëtarë të Unionit "Mirdita" Shkodër, anëtarë të Shoqatës Ushtarakeve, anëtarë të Shoqatës Atletare "Dukagjini" si dhe aktoret e teatrit "Migjeni", Mjeshtër e Madhe Merita Smaja e Drane Xhai, poet e poete, si zonja Life Hasa, Mimoza Rexhvelaj e shume figura të nderuara të qytetit tonë.

Veprimtaria u hap me fjalën e Zija Vukajt, eseist, përkthyes dhe kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shkodër. Ai është një



hës i thellë i letërsisë shqipe dhe autor me mbi 40 vite kontribut në shkollim, mësues i gjuhës dhe letërsisë. Një studiues i neoklasicismit dhe epikës, ai është përkthyes i autorëve botërorë dhe një zë i rëndësishëm në kritikën letrare bashkëkohore.

Zija Vukaj është gjithashtu redaktori i dy librave të Çesk Lukanit dhe autor i



parathënies për secilin prej tyre. Ai e cilësoi autorin si "poeti që shkruan thjeshtë dhe depërton lehtë tek zemra e lexuesit.

Fjalë të ndjera mbajti edhe dukagjinasi Mhill Shkëmbi, personalitet në fushën e biznesit dhe sportit, i cili ndau refleksime personale dhe vlerësime për autorin si njeri me shpirt të butë dhe varg të sin-

qertë.

Ndue Marku, sekretar i Shoqatës "Union Mirdita" dhe mik e koleg i autorit, solli një tjetër perspektivë nga jeta ushtarake dhe njerëzore e Çeskut. Ai, në emër të shoqatës, i dorëzoi Çesk Lukanit një titull nderi "Mirënjohje", vlerësim për kontributin e tij kulturor dhe poetik.

Interpretimet artistike dhe analizat poetike u sollën nga: Drane Xhaj ("Mjeshtër i Madh"), aktore ikonë e skenës shkodrane; Merita Smaja ("Mjeshtër i Madh"), aktore e Teatrit "Migjeni"; Fatbardha Kaçi, poete dhe mësuese; Rozina Sterkaj, poete dhe drejtuese e shkollës "Tringe Smajli"

Uarda Albunesa, avokate dhe poete, anëtare e SHSH Shkodër; Bledar Tafaj, poet, i cili recitoi poezinë "Po vjen Maji" me ndjeshmëri dhe përkushtim; Emili Muhja, balerinë e vogël, solli një ndërthurje artistike përmes lëvizjes së baletit.

Në fund, vetë Autori, Çesk Lukani falënderoi të pranishmit me fjalë të thjeshta e prekëse:

"Fjalët tuaja më dhanë më shumë se çdo varg që kam shkruar - më dhanë përjetësi!"

Veprimtaria u ndoq dhe u transmetua nga RTSh, duke e pasqyruar si një ngjarje të rëndësishme në jetën kulturore të qytetit.

Një mbrëmje, ku fjala poetike u kthye në urë mes kujtesës, shërbimit dhe ndjeshmërisë njerëzore.

Përgatiti:

SENADA DEMUSHI - DELAJ

Bleta - Insekti misterioz dhe i magjishëm

- DITËS BOTËRORE TË BLETËS - 20 MAJ -

Nga të gjithë krijesat e vogla që përshkojnë qiellin e tokës, bleta është pa dyshim ndër më të jashtëzakonshmet. Ajo është një simbol i jetës, rendit, bashkëpunimit dhe prodhimit natyror. E vockël në trup, por kolosale në ndikim, e cila përfaqëson një univers kompleks e të ndërlikuar që mbështet drejtpërdrejtë ekosistemet dhe jetën njerëzore.

Kjo është një ditë, që njerëzit me vizion duhet të reflektojnë!

20 maji është shpallur "Dita Botërore e Bletës" nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), në nder të datëlindjes së Anton Janša, një sloven që në shekullin XVIII njihej si pionier i bletarisë moderne.

Unë jam krejt i vogël në njohuri që kam për bletët, por mjaftueshëm sa për të qenë një ndër pasionet e mija.

Bota e bletëve është një labirint i pafund një fushë frymëzimi, redaksi dhe kënaqësie, por si çdo gjë në këtë bote edhe ajo e Bletës është ne transformim dhe ne krize.

Kjo ditë është thirrje për ndërgjegjësim ndaj kërcënimeve që rrezikojnë bletët sot: pesticidet, ndotja, ndryshimet klimatike dhe humbja e habitatit.

* Jeta e bletëve është një organizim perfekt: një koloni bletësh mund të ketë deri në 60 000 anëtarë, të ndarë në mbretëreshë, punëtore dhe mashkullorë. Mbretëresha është nëna e të gjithëve dhe mund të lëshojë deri në 2 000 vezë në ditë. Punëtoret, femra sterile, kryejnë çdo punë në koshere - nga ndërtimi i foleve, tek pastrimi, pjalmimi dhe mbled-



hja e nektarit. Mashkullorët kanë një jetë të shkurtër dhe shërbejnë vetëm për çiftëzim.

Bletët nuk janë thjesht punëtore të palodhura. Ato komunikojnë përmes valëzimit - një "valle lëkundëse" që orienton të tjerat drejt burimeve të nektarit. Ato kanë kujtesë të fortë, orientim me pozicionin e diellit, dhe ndjeshmëri të lartë ndaj aromave, falë 170 receptorëve të nuhatjes.

Roli i bletëve në natyrë është thelbësor. Përmes pjalmimit, ato ndihmojnë në riprodhimin e rreth 75% të bimëve ushqimore që kultivohen në botë - përfshirë frutat, perimet, arat dhe farat. Mungesa e tyre do të shkaktonte jo vetëm rënie të prodhimit bujqësor, por do të rrezikonte gjithë zinxhirin ushqimor dhe biodiversitetin.

Në aspekt ekonomik, pjalmimi nga bletët kontribuon me mbi 200 miliardë dollarë në vit në bujqësinë globale. Për çdo lugë çaji me mjaltë që hamë, duhet ditë të tëra pune nga mijëra bletë, të cilat vizitojnë miliona lule.

* Mjalti - ari i lëngshëm

Përveç punës së tyre ekologjike, bletët prodhojnë një

nga mrekullitë më të pastra të natyrës - mjalti. Ky nektar i artë është i pasur me antioksidantë, vitamina, minerale dhe ka veti antibakteriale. Që nga lashtësia, është përdorur për të shëruar plagët, për të qetësuar fytyrën dhe për të forcuar sistemin imunitar.

Çdo lloj mjalti - si ai i livandës, luleshtrydhes, gështenjës apo akacies - ka karakteristika të veçanta që varen nga llojet e luleve ku bletët kanë mbledhur nektarin.

* Bleta në rrezik - një alarm për njerëzimin

Në dekadat e fundit, popullatat e bletëve kanë rënë ndjeshëm. Përdorimi i pesticideve, ndotja dhe zhdukja e luleve të egra kanë ulur numrin e kolonive. Kjo është një alarm i qartë: nëse bletët zhduken, edhe ushqimi ynë është në rrezik. Ndaj, është detyrë e përbashkët të mbrojmë habitatet natyrore, të mbështesim bujqësinë e qëndrueshme dhe të edukojmë brezat e rinj për rëndësinë e tyre.

Nëse bleta, kjo krijesë e vogël, e ndaluar mbi një lule, është në gjendje të mbajë mbi krahë gjithë natyrën, ne si njerëz duhet të jemi të vetëdijshëm për madhësinë e saj. Të nderojmë bletën nuk është thjesht një akt dashurie ndaj natyrës - është një zgjedhje për të ruajtur jetën në të gjitha format e saj.

LULASH BRIGJA, maj 2025

Të gjitha rrugët të çojnë në Romë

Shprehja “Të gjitha rrugët të çojnë në Romë” ka origjinë që lidhet drejtpërdrejt me Perandorinë Romake, por mua edhe pse po afrojmë të gjashtëdhjetat rruga nuk me kishte çuar asnjëherë aty,

Kisha lexuar se, gjatë kulmit të Perandorisë Romake, Romakët ndërtuan një rrjet të gjerë rrugësh që lidhte qytetin e Romës me pjesët më të largëta të perandorisë — nga Britania e deri në Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore. Këto rrugë ishin ndërtuar për qëllime ushtarake, tregtare dhe administrative, dhe shumë përfundonin në Forum Romanum, zemra e qytetit të Romës.

Me kalimin e kohës, ajo mori edhe një kuptim metaforik: Pavarësisht se nga fillon, nëse je këmbëngulës dhe i përqendruar, gjithmonë ka një rrugë drejt qëllimit, ashtu si të gjitha rrugët që çonin në Romë!

“Mille viae ducunt homines per saecula Romam” – “Mijëra rrugë çojnë njerëzit prej shekujsh në Romë”.

Rastesia e deshi, që me një grup kolegësh, me një pasion të përbashkët për kulturën e bëmë një vizitë dyditore në qytetin e përrjetshëm, Romën.

Vizita jone u shndërrua në më shumë se një udhëtim turistik: ishte një zhytje në rrënjët e qytetërimit perëndimor, që secili nga ne u argëtua, por edhe mori një leksion real formimi.

Roma duket e ftohte sa e sheh ne pamje të parë e ngurte dhe mistike, por ne ishim të mbushur me entuziazëm dhe kureshtje. Objektivi ynë ishte i qartë: të njihim qytetin, të kuptonim vlerat e tij historike, artistike dhe shpirtërore dhe Roma, si gjithmonë, nuk zhgënjën.

Sa shumë kemi lexuar dhe dëgjuar për këtë djep të lashtë të kulturës, historisë arkitekturës dhe qytetërimit Evropian?!

Roma është unike në shumë mënyra, dhe ka disa gjëra që i gjen vetëm aty, ose që janë veçanërisht të lidhura me të.

Roma është histori reale ku e prek me dorë një qytet antikiteti bashkëjeton me modernitetin, por numri i madh i turistëve duket si një lumë që mbush qytetin.

Atmosfera romantike, jetesa e qetë, kafetë e vogla, sheshet dhe shëtijtjet nën dritën e perëndimit janë tipike romane. Aty ndjen “shijen e jetës” që Fellini e përshkroi në filmat e tij. Arti dhe arkitektura unike në asnjë qytet tjetër nuk gjen një përzierje kaq të pasur të stileve arkitekture: antike, mesjetare, baroke, dhe moderne – të gjitha në një hapësirë relativisht të vogël. Nëse veçojmë rruga Appia Antica – Një nga rrugët më të vjetra romake, që ende mund të ecësh mbi të, duke ndjekur gjurmët e lashtësisë në natyrë.

Në thelb, Roma është një qytet ku koha është shtresuar: çdo hap të sjell në një epokë tjetër, dhe kjo është një ndjesi që nuk e gjen askund tjetër në të njëjtën mënyrë.

Kur je përballë “Coloseut” dhe imagjinata fluturon dhe të duket sikur po përjeton një ëndërr!

* **Coloseu** – Arena ku historia ende jehon, u ndërtua në vitet 72–80 pas Krishtit nga perandorët Vespasian dhe Tit.



U përdor për rreth 400 vjet për spektakle publike. Strehoi deri në 50 000 spektatorë.

Emri “Coloseu” vjen nga një statujë gjigande e Neronit, që ndodhej aty pranë. Sa pa vlerë më duken gradaçelat e larta te



kohës moderne përpara këtij amfiteatër Antik.

Harku i Triumfit dhe gjithë ambientet përreth të duket sikur je / ni, duke jetuar disa shekuj më parë, të duket sikur po dëgjon zhurmat dhe klithmat e gladiatorëve të asaj kohe!

* **Forumi Romak** – Zemra politike e Romës së lashtë:

Funksionoi që nga shekulli i 7-të p.e.s. Ishte qendra e jetës politike, fetare dhe tregtare të qytetit.

Rruga “Via Sacra”, që kalon përmes tij ishte vendkalimi i triumfeve ushtarake.

Piazza Venezia dhe Altare della Patria aty ku ora kalon si një minute dhe nuk pyet kurrë veten sa je lodhe duke ecur!

Monumenti madhështor, në nderim të mbretit të parë të Italisë së bashkuar, Victor Emmanuel II. Përmban Varrin e Ushtarit të Panjohur dhe një flakë përkujtimore.

Njihet edhe si “makina e shkrimit”

për shkak të formës së saj karakteristike. Aq shumë gjëra madhështore statuja dhe vepra artistike sheh aty sa vetëm, kur largohesh e kupton se nuk mjafton një muaj për të ngop kureshtjen tënde

* **Fontana di Trevi** – Mes dëshirës dhe



tradiçës

U përfundua në vitin 1762 nga arkitekti Nicola Salvi.

Është fontana më e madhe baroke në Romë. Të mendosh se një mrekulli si kjo është bërë shumë shekuj më parë arritjet e shkencës sotme të duken grimca në hapësirë. Një magji dhe art deri në perfeksion. Sipas traditës, nëse hedh një monedhë në fontanë, do të rikthehesh përsëri në Romë.

* **Vatikan** – Frymëzimi që vjen nga arti dhe besimi. Sa herë e kam ëndërruar, që të shkel me këmbë në atë vend të Shenjtë, të shijoj madhështinë dhe të bej edhe unë lutjet e mija!?

Sheshi i Shën Pjetrit dhe Bazilika. Projektuar nga Gian Lorenzo Bernini. Bazilika u ndërtua mbi varrin e Shën Pjetrit.

Kupola është një nga veprat më të mëdha të Michelangelo-s.

Kapela Sistine dhe Muzeu i Vatikanit Kapela Sistine u ndërtua në shekullin XV. Tavani dhe Gjykimi i Fundit u piku-

ruan nga Michelangelo.

Muzeu i Vatikanit ka mbi 70 000 vepra arti, duke përfshirë Galerinë e Harqeve, Galerinë e Hartave dhe shumë të tjera. Nuk e di sa ore e sa foto kam bërë aty, por është vërtet një mrekulli.

* **Santa Maria Maggiore** – Një nga thesaret shpirtërore të Romës.

Është një nga katër bazilikat madhore të Vatikanit dhe ruan strukturën që nga shekulli V. Sipas traditës, një borë në gusht të vitit 358 tregoi vendin ku Zoti dëshironte ndërtimin e saj.

Në vitin 2025, Papa Françesku u varros këtu, si një akt përkushtimi ndaj ikonës “Salus Populi Romani”.

* **Lumi Tiber**, është lumi i tretë më i gjatë në Itali, pas Po dhe Adige, dhe ka një rëndësi të madhe historike, kulturore e fetare, për qytetin e Romës.

Sipas mitologjisë romake, Romuli dhe Remi, themeluesit legjendarë të Romës, u lanë në ujërat e Tiberit si foshnje dhe u shpëtuan nga një ujeshkë. Kjo legjendë e lidh direkt lumin me lindjen e qytetërimit romak.

Thuhet se emri i lumit vjen nga një mbret i hershëm latin, Tiberinus, i cili u mbyt në lumë dhe u shndërrua në hyjni të tij.

Gjatë periudhës së Republikës dhe Perandorisë Romake, Tiberi ishte një rrugë ujore thelbësore për tregti dhe transport. Roma përfitoi shumë nga vendndodhja e saj pranë këtij lumi, që e lidhi me detin dhe pjesët e tjera të Italisë.

Në ditët moderne, Tiberi rrjedh përmes zemrës së Romës, duke kaluar pranë monumenteve të famshme si Engjëlli (Castel Sant'Angelo) dhe Vatikan. Urat historike që e lidhin dy anët e qytetit janë pjesë e peizazhit të veçantë romak.

* **Trastevere** – Roma e jetës së përditshme. Emri do të thotë “matanë lumit Tiber”. Lagje historike e punëtorëve dhe artizanëve.

Ndaluam në grupe të vogla, për një darkë për të përjetuar sadopak atë adrenalinë që të jep mbrëmja aty. Shijum zhurmat dhe dritat e natës në një nga zonat më të gjalla me kuzhinën tradicionale romake si “cacio e pepe”, “suppli” dhe “carciofi alla giudia”. Ndoshta këto rrugica kishte në mendje Marubi, kur e ideoi shëtitorën e sotme të Shkodrës apo rrugën tradicionale të Gjuhadorit. Në dy ditë pamë më shumë se monumente.

Falënderimi i parë shkon për grupin drejtues të shkollës tone “Maria Ndihamëtare”, që na krijoi një mundësi të tillë, në veçanti për superiore të tonë Motër Michaela Kubickova pastaj te gjithë kolegeve për alegrinë dhe atmosferë.

Përjetuam Romën si një libër të hapur, me faqe të gdhendura në gurë, ngjyra dhe frymë hyjnore. Ky udhëtim ishte mësim, emocion dhe frymëzim.

Ndoshta, siç thotë një fjalë e vjetër latine – Sa e madhe ka qenë Roma, e mësojmë nga rrënojat e saj!

Përgatiti Lulash Brigja

Gjuha shqipe dhe fëmijët tanë jashtë Shqipërisë



FRAN GJOKA

“Historikisht mërgimtarët shqiptarë kanë punuar, kanë jetuar dhe janë përpjekur që fëmijëve të tyre t’ua mësojnë dhe ta ruajnë gjuhën shqipe. Kjo traditë e çmuar, si amanet i rëndë i të parëve tanë, “që së tret dhe i huaj”, deri në ditët tona, duhet të ruhet. Hemorragjia e pasviteve ‘90 të shekullit të kaluar”...

Emigracioni, gjatë gjithë periudhave të historisë, ka qenë dhe është një fenomen tipik social me karakter ndërkombëtar. Edhe Shqipëria në këtë aspekt nuk ka bërë dhe as nuk bën përjashtim. Periudha e vështirë e tranzicionit u shoqërua me një hemorragji të pandalshme të procesit të emigrimit të popullsisë së vendit tonë, sidomos në drejtim të vendeve perëndimore, në kërkim të kushteve më të mira të jetesës, sigurisë për të ardhmen dhe kualifikimit arsimor të fëmijëve. Pra, emigrimi i popullsisë në përgjithësi dhe i fëmijëve në veçanti, krahas anës pozitive, mbart me vetvete edhe rrezikun e një fuzioni apo asimilimi gradual të gjuhës sonë shqipe, sidomos tek fëmijët dhe tek rinia shqiptare që jeton aktualisht në mërgim. Fatet ekzistuese të një kombi përcaktohen në fund të fundit nga gjuha dhe kultura e tij. Popullsia e një vendi, që për arsye të ndryshme nuk e shkruan dhe rrallë herë e flet gjuhën e tij amtare, është i prirur të rrezikohet, pasi gjuha ka qenë dhe mbetet një ndër komponentët kryesorë të kulturës së një kombi. Kur njeriu nuk e ka nën këmbë tokën e vet, humbet diçka nga qëndrimi i tij vertikal, humbet sigurinë dhe në shumë raste bëhet më skeptik ndaj vetvetes. Është interesant fakti se gjuha shqipe ka një zhdërvjelltësi në të folur, është shumë burrërore dhe mjaft e bukur. Këtë e kanë vënë re edhe mjaft albanologë dhe gjuhëtarë, të cilët kanë vënë re se kur dëgjohet e folura e shumë vendeve të Evropës, duke krahasuar me shqipen, gjuha jonë ka një tingull të veçantë dhe mjaft impulsive. Kjo ndodh sepse shqipja është vazhdim i gjuhës ilire dhe i përket grupit të gjuhëve Indo – Evropiane pra, veçohet si një nga më të vjetrat në Evropë dhe Ballkan. Është detyrë imperative e mësuesve atdhetarë shqiptarë për t’u mësuar dhe shkruar gjithnjë shqipen brezave të fëmijëve emigrues e shoqëruar me një përkushtim në hapjen e shkollave të reja në gjuhën shqipe. Shqiptarë të vërtetë, patriotë dhe atdhetarë ka plot, si ata që dërguan libra, hapën shkolla, hartuan programe, mësues që punojnë me devotshmëri për vite me radhë jashtë Shqipërisë, nuk mungojnë. Këtu më vjen në

mend një thënie e një emigranti me banim në Itali, i cili, kur ra fjala për gjuhën e nënës, më pati thënë: “...Gjuha është e vetmja armë që vërteton se ne jemi shqiptarë kudo që ndodhemi...”. Parë nga ky këndvështrim, përfitoj nga rasti t’u bëj thirrje mësuesve atdhetarë, prindërve emigrantë, që t’u mësojnë fëmijëve si ta flasin dhe të shkruajnë pa ndërprerje shqipen, gjuhën që të parët tanë na e lanë për ta përdorur përgjithmonë të pastër.

Historikisht mërgimtarët shqiptarë kanë punuar, kanë jetuar dhe janë përpjekur që fëmijëve të tyre t’ua mësojnë dhe ta ruajnë gjuhën shqipe. Kjo traditë e çmuar, si amanet i rëndë i të parëve tanë, “që së tret dhe i huaj”, deri në ditët tona, duhet të ruhet. Hemorragjia e pasviteve ‘90 të shekullit të kaluar, që ka bërë tashmë të shpërngulen nga atdheu, për një jetë më të mirë, me gjithë familjen, me djem dhe vajza mjaft familje shqiptare, ka detyruar mërgimtarët shqiptarë, këtej e matanë kufijve shtetërorë, që t’iu përshtaten kërkesave të reja të epokës së globalizimit, ku është bërë eminent rreziku i humbjes së kulturave nacionale, pra edhe të gjuhës nga breznitë e reja. Është për t’u theksuar se tashmë për fëmijët e mërgimtarëve janë hapur shkolla të shumta në vende të ndryshme, ku fëmijët marrin në mënyrë të organizuar mësim plotësues në gjuhën amtare nga mësues patriotë e pasionantë, të cilët, në të shumtën e rasteve, e japin ndihmën e tyre vullnetarisht. Shembujt janë të shumtë dhe gjendja e këtyre shkollave, mund të themi se përfshin hapësira të reja, ku jetojnë e punojnë shqiptarët emigrantë. Në përgjithësi për çeljen dhe mbarëvajtjen e këtyre shkollave, kanë dhënë ndihmën e tyre dhe drejtuesit e pushtetarët lokalë si në qytetet Nju Jork, Bruksel, Hamburg, Berlin, Frankfurt, Oslo, Athinë etj. Është pozitiv fakti se në shumë qytete në Amerikë, aty ku komunitetet shqiptare janë të organizuar, janë ngritur dhe funksionojnë shkolla dhe kurse në gjuhën shqipe. Po kështu në Kanada janë hapur shkolla shqipe. Në Evropë ka shembuj pozitivë të funksionimit të këtyre shkollave si në Zvicër, Gjermani, Suedi, Itali etj., ku funksionojnë shkolla të hapura nga vetë shqiptarët, sidomos nga ata të Kosovës dhe të trojeve të tjera ku jetojnë shqiptarë. Synimi i këtyre vendeve dhe shkollave mbetet i qartë: fëmijët e mërgimtarëve të zotërojnë mirë shkrim – lexim në gjuhën amtare shqipe, ta kultivojnë atë dhe letërsinë shqipe, të njohin historinë dhe gjeografinë etnike të vendit të të parëve, si dhe artin, kulturën dhe traditat kombëtare. Rëndësi e veçantë, në këto shkolla shqipe u kushtohet veprimtarive të lira jashtë klase, si puna me librin, funksionimi i bibliotekave, konkurse dhe biseda për librin etj. Në ekranet televizive kemi dëgjuar cicërimat e bukura, emocionale dhe krenare të fëmijëve shqiptarë në gjuhën e bukur amtare, në tubime të tyre, të prindërve dhe të komunitetit. Vërtetë jetojmë në një shoqëri të lirë e të hapur, vërtetë jemi përkras të globalizimit dhe të rejave që po hyjnë në shkencë dhe teknikë, por nuk do të dëshironim kurrë që gjuha jonë e bukur të mos shkruhej e të përdorej nga shqiptarët e të gjitha brezave që do të vijnë. Mundësitë për ta mbajtur të gjallë gjuhën e bukur shqipe, gjuhën e Naimit tek fëmijët, nipërit, mbesat dhe stërnipërit tanë, pa-

varësisht se ku lindin e ku jetojnë ata, janë evidente. Ata pavarësisht nga mjedisi i huaj ku jetojnë e punojnë, nga rrethanat aspak favorizuese për të përdorur gjuhën shqipe, askush nuk i pengon të flasin vetëm shqip në familje, të komunikojnë me fëmijët e tyre vetëm përmes gjuhës sonë amtare. Fjala vjen, të mos na duket vetja modern kur në çdo fundjavë me familjen kalojmë në njërin prej lokaleve angleze, italiane, gjermane, greke të mos fyhemi nëse flasim në ambiente të tilla familjare në gjuhën tonë të bukur.

Për shqiptarët emigrantë, me gjithë përpjekjet e mundimshme për ruajtjen e gjuhës, shqipja po bëhet sa e largët dhe e huaj për fëmijët e tyre. Është normale që duke jetuar në një shoqëri ku flitet një gjuhë tjetër, kup-tohet dhe tendenca e kufizimit dhe shqiptimit të shqipes, por fëmijët duhet të projektojnë të ardhmen e tyre aty ku rriten pa harruar gjuhën e mëmëdheut, ashtu siç e ruajtën për qindra shekuj me radhë arbëreshët e Italisë. Prandaj komuniteti prindëror duhet të tregohet i kujdesshëm në ruajtjen e shqipes. Në demokracinë gjermane, askush nuk gëzon respekt se i cilës kombësie je dhe çfarë kontributi ke dhënë, por në radhë të parë është aftësia në fushën e prodhimit dhe shkollimit, prandaj për ne shqiptarët modeli gjerman i shkollës dhe i edukimit është një model që duhet imituar në rrugë origjinale nga shqiptarët mërgimtarë. Nuk duhet të pretendohet të gjendet një zgjidhje – mrekulli, por të bëhet ajo që është e mundur, ajo që varet nga ne shqiptarët.

Ka vite që në Shqipëri vazhdon hartimi dhe shpërndarja e një abetareje mbarëkombëtare. Efekti i saj në diasporë e gjetkë po ndihet më së miri, shihet se ka një interesim maksimal për këtë tekst të ri të gjuhës shqipe. U bënë vite që është krijuar këshilli ndër akademik Kosovë – Shqipëri, për një shqipe standarde. Të dy akademitë, duke pasur parasysh se gjuha shqipe është tipari kryesor i kombësisë shqiptare, mjeti themelor që siguron ndërlidhjen shpirtërore ndërmjet hapësirave e vendeve shqipfolëse, synojnë që zotërimi dhe përvetësimi i shqipes standarde të jetë objekti themelor i brezave të sotëm.

Shpresojmë se Këshilli Ndër akademik do të merrret si gjithnjë me vrotimet dhe vlerësimet e politikave gjuhësore për ta bërë shqipen tonë një gjuhë mbarëkombëtare, sepse emigracioni ndërkombëtar shqiptar është shpërndarë në Greqi, Itali, Gjermani, Mbretëri e Bashkuar, Belgjike, Francë, SHBA, Kanada, Zvicër, Suedi, Austri etj. Janë më shumë se 1/3 e fëmijëve që jetojnë e mësojnë shqip në këto vende.

Me gjithë predispozitën e prindërve për të kontribuar në ngritjen e shkollave, apo për të hapur klase për mësimin e gjuhës amtare, ende ka probleme në këto vende. Është emergjente të kërkohet legalizimi në rrugë shtetërore për nisim të veçanta, që duhet ndërmerren dhe kërkohet të mendohet nga organet Kombëtare të hapen dhe funksionojnë shkolla, si në vendin tonë ashtu edhe në vendet e tjera ku kërkohen të ngrihen këto shkolla për mësimin e shqipes. Nëse ne shqiptarët bëjmë të pamundurën për ruajtjen e gjuhës shqipe, edhe shteti shqiptar të programojë diçka të frytshme, pra të organizojë dhe të drejtojë veprime drejt rrafshimit të dallimeve të krijuara si pasojë e ndarjeve politiko – administrative, që sjellin jo pak vështirësi në komuni-

kimin kombëtar, atëherë gjuha jonë do të zërë vërtetë vend të nderuar mes gjuhëve të tjera evropiane. Vetëm kështu u vijnë në ndihmë në ruajtjen e gjuhës shqipe fëmijëve shqiptarë që jetojnë përkohësisht jashtë Shqipërisë. “Shkolla” e familjes mërgimtare për mësimin e gjuhës shqipe, kërkon veç të tjerave të mbështetet më mirë nga politikat arsimore shtetërore me mësues e programe shkencore. Me të drejtë preokupohe mi për analfabetizmin në sistemin tonë arsimor dhe në shkollat tona, por ç’emër t’i vëmë atyre dhjetëra qindra fëmijëve shqiptarë, që ende vetëm e belbëzojnë gjuhën shqipe pa lë të njohin historinë, kulturën, gjeografinë dhe traditat e këtij kombi. Kësaj drame duhet t’i jepet fund! Shumë përgjegjësi kanë intelektualët shqiptarë që jetojnë dhe vepronë në emigrim. Ata duhet të jenë më aktivë dhe më krijues në organizimin sa më efektiv të kurseve, shoqatave dhe shkollave për mësimin e gjuhës amtare.

Indiferentët, dembelët dhe ata që nuk vazhdojnë rrugën që hapën Rilindësit tanë, historia do t’i dënojë dhe shoqëria njerëzore do të mbajë qëndrim kritik ndaj tyre. Nga Bostoni i Amerikës, Konica, para shumë vitesh, do të shprehej: “...Erdhi më në fund dhe për gjuhë shqipe koha e lulëzimit, koha plot shpresë! Me të katër anët, një zjarr i bukur zien në zemër të djalërisë, dhe plot me dëshirë, trimoshët e dheut tonë po përpiqen për zburimin e shqipes. I vlerësojmë, i pranojmë dhe i respektojmë vlerat gjuhësore e kulturore të popujve të tjerë. Dhe respekti për të tjerët ka vlerë e besueshmëri, kur në radhë të parë respekton vlerat e kombit tënd...!”

Kohët e fundit, në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të qytetit të Shkodrës u organizua seminari i XII mbarëkombëtarë me temë “Për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, ku morën pjesë mjaft gjuhëtarë nga trojet shqiptare dhe diaspora, ku u shtrua problemi i përmirësimit të modeleve të mësimdhënies në shkollat shqipe në mërgatë si dhe shkëmbimi i përvojave në këtë fushë. Shpresëdhënëse ishin edhe fjalët e Ministres së Arsimit dhe Sportit, z. Lindita Nikolla, e cila mori pjesë në takim, ku ndër të tjera tha: “...Qeveria shqiptare ka vullnetin për të plotësuar detyrimin ndaj fëmijëve të emigrantëve, që ata të mësojnë gjuhën shqipe dhe kulturën kombëtare. Gjuha amtare përbën shenjën e parë të identitetit kombëtar, si e tillë ajo duhet mësuar dhe zhvilluar...”, por tani presim që specialistët dhe metodistët e dikasterit të hidhen në veprimtari konkrete bashkëpunimi për hapjen, kompletimin me tekste dhe funksionimi e shkollave shqipe në diasporë.

Është i dyti shkrim problemor në llojin e tij, që shtron nevojën e një impenjimit dhe vlerësimit më të madh nga organet shtetërore dhe prindërit mërgimtarë që të punohet maksimalisht me fëmijët e tyre për të folur e shkruar gjuhën tonë amtare shqipe. Vetëm kështu e mbajmë gjallë gjuhën shqipe tek fëmijët mërgimtarë, duke ngulmuar më shumë se deri tani komunikimin në gjuhën e bukur amtare, duke ngulmuar më shumë se deri tani për të sotmen dhe vetëm kështu shqiptarët do të jenë të denjë për të hyrë në familjen e madhe evropiane, duke i shërbyer të ardhmes së brezave të rinj përmes fjalës së bukur shqipe. Vetëm kështu rritet krenaria kombëtare e kombit tonë. Ndoshta nesër do të jetë vonë...

Familja Albani

FAMILJA SHQIPTARE - ALBANI, NGA URBINO DHE BERGAMO E ITALISË, "GJENEALOGJINË" E SAJ E KISHTE SHQIPTARE DHE VINTE NGA SHQIPËRIA (LAÇI).

Në bazë të disa shënimeve dhe disa dokumenteve arkivore ekzistuese, bëhet e njohur se të parët e familjes Albani: Gjergji, Filipi dhe Andrea (djemtë e Mikelit), kishin shkuar si refugjatë shqiptarë (diku shkruhet si disidentë të Perandorisë Osmane), por në disa burime të tjera shënohet dhe dëshmohet se të parët e familjes Albani, djemtë e Mikel Lazit: Gjergji dhe Filipi, ishin diplomatë dhe ushtarakë të njohur të Gjergj Kastriotit, të dërguar me detyra të caktuara diplomatike e ushtarake dhe të akredituar në pallatin e Dukës së Urbinos - Federiko Montefeltro, më 1464.

Në disa dokumente të tjera bëhet fjalë se Mikel Laci kishte pasur dy djem: Gjergjin dhe Filipin, ndërsa në dy - tre dokumente të tjera kam gjetur edhe në një emër tjetër të djalit të tretë të Mikelit, i cili quhej Andrea, mirëpo nuk shkruhej më tej se ku jetoi Andrea, ku punoi dhe as për ndonjë pasardhës të tij.

Gjergji dhe Filipi, pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, më 1468, nuk u kthyen kurrë në Shqipëri. Atje u sistemuan, u martuan dhe u shtuan me gjenerata, duke jetuar përgjithmonë në Itali, por brezat e tyre dhe familja Albani i bëri nder të madh, jo vetëm Urbinos e Bergamos, por edhe Kishës Katolike dhe Evropës e, në veçanti, kombit shqiptar, sepse kjo familje shqiptare u bë e njohur në mbarë Evropën e më gjerë, si familje aristokrate, klerikale, papate, diplomatësh dhe kardinalësh...

Familja shqiptare - Albani, pas vendosjes në Itali (Urbino), ajo do të ndahet në dy degë kryesore, ku njëri djali i Mikelit - Gjergji ngel në Urbino, ndërsa djali tjetër i Mikelit - Filipi vendoset në Urbino të Italisë.

Më vonë, pjesëtarët e familjes Albani, janë të shpërndarë nëpër Itali, e më vonë i gjejme edhe në vende të ndryshme të Italisë, si: Romë, Venedik, Bolonjë, e të tjera.

Për familjen aristokrate të famshme Albani, shkruajnë edhe shumë enciklopedi të njohura botërore, të cilat shkruajnë se familja Albani ishte shqiptare dhe vinte nga Shqipëria.

Në disa dokumente, shume arkiva dhe enciklopedi të vendeve të huaja, ku shkruhet për gjenezën e familjes shqiptare Albani dhe të Papa Albanit, shkruhet, po ashtu, edhe për të parin e familjes Albani - Mikelin.

Mikel Lazi (Michaele Lazii), në disa Laçi, e në disa Lazzy, shënohet se djemtë e tij ishin: Gjergji (Georgio) dhe Filipi (Filippo), e në disa edhe Andrea. Ata shënohet se më 1464, katër vite para se të vdiste, Gjergj Kastrioti, ata kishin ardhur dhe ishin vendosur në Urbino të Italisë.

Nga këta dy djem të Mikel Laci: Gjergji dhe Filipi, u shtuan dhe u vazhdua me gjenerata të tëra familja Albani. Është interesante se në asnjë enciklopedi nocioni "Lazii", nuk shtjellohet njësoj dhe më gjerë dhe nuk bëhet fjalë se ky nocion a ishte emri i babait të Mikelit, mbiemër i tij apo


vendi, ku ka jetuar Mikeli në Laç.

Jam shumë i bindur se ky nocion ka qenë emri i vendit Laç, në Shqipërinë Veriore dhe pikërisht, ky mbiemër i Mikelit (Laçi), duhet të shënojë vendin e origjinës së Mikelit.

Raste dhe shembuj të tillë ka mjaft në praktikë te shqiptarët, të cilët emigrojnë në vendet e huaja e marrin mbiemrin e

- Albani dhe familja Albani ishin shqiptar të kulluar

Sa i përket dëshmisë dhe argumentimit shkencor dhe objektiv se familja Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë ka qenë me origjinë shqiptare, kjo dëshmohet dhe vërtetohet edhe në të gjitha dokumentet ekzistuese-arkivore, si dhe në enciklopedi të shumta të vendeve të huaja, të cilat



fshatit, të qytetit, të vendbanimit ose të përkatësisë kombëtare, si p. sh: familjet shqiptare në Egjipt, Siri e gjetiu, mbajnë mbiemër arnavud, në Itali familja shqiptare e Papa Klemensit XI quhej ALBANI, në Greqi quhen arbanitë (arvanitë), por ka edhe shumë raste, ku familjet e emigruara shqiptare në vendet e huaja të marrin mbiemrin e vendit, ku kanë jetuar (qytetit apo fshatit), si p. sh: familjet muhaxhirë, të ikur nga Serbia Jugore, më 1876/77 dhe 1878 edhe sot quhen sipas vendeve të tyre në Serbi: Toplica, Trenava, Toplana, Vranovci, Pllana, Kolludra, Prebreza e të tjera. Prandaj, edhe Mikel Laçi ka pasur mbiemër të vendit të tij - Laç.

Edhe djemtë e Mikelit Laçit: Gjergji dhe Filipi u quajtën albanezi, ndërsa djali i Gjergjit, Altobeli (jetëgjati) nga albanezi e shndërron mbiemrin e tyre në ALBANI.

Disa të dhëna arkivore, të cilat dëshmojnë dhe vërtetojnë, se Papa Kelmendas XI

hina e Shqipërisë Veriore, ku e folmja e të cilëve i përkiste të folmes shqipe të dialektit gegë.

Autori, Atë Maria da Lecce në parathënie të Gramatikës së tij, së pari, i drejtohet dhe i arsyetohet (Arbnorit) Papa Albanit (Klemensit XI) për hartimin dhe shkrimin e Gramatikës së gjuhës shqipe, duke iu drejtuar Papa Albanit: "Arbënorit" (lexo -Albanit) "Arbenuer i dasctun, Gramatiken nuk e shkrova për zotniin tande" (Albanin), sepse Papa Albani Gjuhën Arbnore e dinte shumë më mirë se vetë hartuesi i Gramatikës - Ata Francsco de Lecce.

Se familja shqiptare Albani e Papa Klemensit XI rridhte nga fisi shqiptar - Kelmendi, e hasim të shënuar ndër të tjerash

burime i kam hasur vetë dhe i kam pasur nëpër dorë. Edhe vetë anëtarët e familjes Albani me gjenerata të tëra dhe me mburrje përherë e kanë ruajtur dhe e kanë mbajtur me krenari thirrjen (mbiemrin): ALBANI.

Ky mbiemër simbolizonte ndjenjën e përkatësisë së tyre kombëtare - shqiptare të albanëve, si dhe prejardhjen e tyre nga Shqipëria. Familja Albani vinte nga kra-

edhe te libri i historianit të njohur gjermanofon: Dr. Heinrich Berghaus: Die Völker des Erdbals, Brüssel und Leipzig, Zweiter Band, 1854, fq. 187-188.

Papa Albani zgjodhi (dhe e mori) zyrtarisht thirrjen kishtarë - papnore: "Klemens i XI", si Pontifex Maximus i zgjedhur. Si një atdhetar që ishte, Papa Klemens XI, në kujtim të Shqipërisë, ai thirrjes së tij zyrtare - kishtarë, "Klemens



Gjergj Kastrioti në Botë

Të nderuar zonja dhe zotërinj të pranishëm në këtë konferencë shkencore për Gjergj Kastriotin!

Kam kënaqësinë të jem i pranishëm në këtë konferencë për të ju përshëndetur për pjesëmarrjen tuaj dhe për të falënderuar organizatorët e këtij takimi në shërbim të njohjes dhe kujtimit të krye heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti i njohur në botë si Skënderbeu.

Shqipëria është një vend i vogël, por me një histori të lashtë dhe të lavdishme.

Populli shqiptar ka luftuar gjatë njëzet shekujve kundër pushtuesve të ndryshëm, të cilët në shumë raste kanë ushtruar edhe gjenocid ndaj popullsisë paqësore të kombit tonë.

Në historinë e dy mijë viteve të fundit nuk është regjistruar asnjë rast që populli shqiptar të ketë sulmuar ose pushtuar shtetet fqinje ose kudo në botë.

Nga kjo tribunë e fjalës së lirë ju tërheq vëmendjen studiuesve dhe institucioneve më të larta të shkencës së historisë shqiptare në Shqipëri dhe në Kosovë, që në asnjë rast nuk e kanë ngritur zërin për njohjen e gjenocidit të ushtruar nga pushtuesi turk ndaj popullit shqiptar megjithëse janë të njohura dhe të dokumentuara masakrat mizore të ushtruara nga ky pushtues gjatë gjithë kohës së pushtimit të tij.

Perioda më e lavdishme e popullit tonë mbetet qëndresa antiosmane gjatë njëzet e pesë viteve të udhëhequra nga Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastrioti.

Gjergj Kastrioti, hero i kombëtar, ka të vendosur qindra buste e monumente, në më shumë se njëzet shtete të botës, duke ja kaluar të gjithë udhëheqësve politik dhe ushtarakë nga e gjithë bota për numrin e tyre dhe vendeve ku janë vendosur.

Ky fakt i njohur ndërkombëtarisht e ka shpjegimin e vet krejtësisht të qartë. Gjergj Kastrioti, udhëheqës i Arbërisë

dhe Gjeneral ushtarak i njohur nga gjithë Evropa si "Kalorësi i Krishterimit", gjatë gjithë karrierës së tij ushtarake luftoi për mbrojtjen e vendit të tij dhe të vendeve të tjera evropiane nga invadorët osmanë që donin të pushtonin Shqipërinë dhe Ev-



ropën.

Ai zhvilloi vetëm beteja mbrojtëse dhe asnjëherë nuk sulmoi ndonjë vend tjetër. Kjo është arsyeja që ai është kampion i ushtarakut që ka luftuar për liri dhe pavarësi.

Kombi shqiptar ka pasur në shekuj sjellje korrekte dhe paqësore me fqinjët e tij në lindje dhe në perëndim, në jug dhe në veri të vet.

Kanë qenë popujt e tjerë që e kanë sulmuar dhe djegur e shkatërruar ekonominë dhe kulturën e popullsisë arbërore në trojet e veta.

Në zonat e Arbërisë dhe Dardanisë,

pushtuesi turk, sipas dokumenteve të publikuara dhe të pakundërshtueshme organizoi një terror dhe gjenocid të pa parë më parë në këto troje.

Për ti shpëtuar kësaj dhune dhe këtij gjenocidi, popullsia e këtyre zonave u lar-

Vetëm popullsitë që u vendosën në viset jugore të Italisë, që sot quhen arbëresh, arritën të ruanin gjuhën, kulturën, veshjet, fenë dhe kombësinë e tyre të pa dhunuar nga mikpritësit e tyre.

Janë këta arbëresh që kanë hapur shkollat e para shqipe, që kanë shkruar shkrimet e para dhe librat shqip duke kontribuar në ruajtjen e identitetit tonë kombëtar.

Në këtë pritje vëllazërore të bashkëkombësve të tij ka pjesën e vet edhe vepri dhe lidhjet që krijoi në të gjallë të tij hero i ynë kombëtar Gjergj Kastrioti.

Në qytetet italiane ka mbi njëzet sheshe me emrin e Skënderbeut dhe më shumë se 50 buste të vendosura në sheshe publike dhe institucione në shtetin Italian.

Për Skënderbeun buste dhe shtatore janë vendosur në sheshe dhe vende publike edhe në Argjentinë, SHBA, Kanada, Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikë, Francë, Zvicër, Austri, Kroaci, Poloni, Rumani, Bullgari, Maqedoni, Kosovë, Shqipëri dhe në shumë vende të tjera, duke e bërë heroin tonë kombëtar figurën më të njohur të luftës çlirimtare, për një pjesë të rëndësishme të popullsisë së të gjithë globit tokësor.

Sot, ne në këtë sallë, por edhe të gjithë bashkëkombësit tanë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në të gjitha vendet ku punojnë dhe jetojnë shqiptar festojmë dhe nderojmë kujtimin e lindjes së heroit tonë kombëtar me një krenari të ligjshme që populli shqiptar i ka dhënë botës një gjeneral ushtarak që nga gjithë bota njihet si "Atlet i Krishtit" për kauzën e drejtë dhe për betejat që udhëhoqi njëzet e pesë vjet si prijës i popullit shqiptar.

Ju faleminderit!

MARK PALNIKAJ,

Prishtinë më 6 maj 2025

XI", ia bashkëngjit edhe mbiemrin e familjes Albani.

Familja Albani është njëra ndër familjet më të njohura në Itali, e cila jetonte më parë në vendin e Shqipërisë (...).

Në J. S. Ersch - J. G. Gubner: "Allgemeine Enzyklopädie der Wissenschaft und Kunst"/Teil-2./-Graz - Austri, 1969, fq. 336-337, me gjasë është huazuar teksti nga fjalori i mësipërm i Johann Gubnerit i vitit 1732, ku, po ashtu, shkruhet se kardinalët Albani rrjedhin nga një familje shumë e famshme italiane, e cila në kohët më të vjetra lulëzonte në vendin e Greqisë - Shqipëri, që u arratis nga Despotati Grek për në Itali (...)"!

Në "Grand Larousse Encyclopedi", Paris VI-e, 1960, fq. 206 shkruhet, po ashtu, se familja Albani e Papa Klemensit XI ishte një "familje refugjatësh" e ardhur nga Shqipëria në Itali, duke përmendur invazionin turk në Shqipëri, si vijon: "Albani, familie de Roma, originaire de l'Albanie et refuge en Italie, apres l'invasion des Turcs, au XV-e. S. (...)"

Në "J. Fr. Michaud: Biographie Universelle Ancienne et Moderne (I) AA-ANG-Graz-Austria, 1966, fq. 309-312 shkruhet,

po ashtu, se familja Albani e ka origjinën nga Shqipëria, e cila si refugjat ka ardhur në Itali në shekullin e XVI dhe është e ndarë në dy degë: Urbino dhe Bergamo.

Në Fjalorin Enciklopedik Italian: "La Piccola Treccani - Dizionario Enciclopedico", Roma, 1995, fq. 234 shkruhet se familja Albani e Papa Klemensit XI vjen nga Shqipëria në Urbino, në vitin 1464, ku i pari i tyre ishte Mikel Lazii dhe shkruhet për djemtë e tij: Gjergjin dhe Filipin, si vijon: "Albani - Famiglia d'alta tradizione prelatizia, originaria dell'Albania; nel 1464 si stabili a Urbino tal Michele Lazii, i cui figli, Giorgio e Filippo (...)"

Në "Enciclopedia Zanichelli" - 2002, Bologna, në fq. 47 shkruhet se familja Albani vjen nga Shqipëria, në vitin 1464 dhe rrjedh nga Mikel Lazii: "Albani Famiglia di origine albanese discendente da Michele Lazii, trasferitosi a Urbino nel 1464 (...)"

Në "OTTŪV - SLOVNĀK NAUČNY - ILLUSTRVANĀ ENCYKLOPĒDIE OBECNÝCH VĚDOMOSTI, PRVNĀ DĪLA - Alpy", Paseka, 1996, fq. 693, po ashtu, e gjejmë të shkruar se familja e famshme Albani ka prejardhje shqiptare,

e cila është vendosur në Itali, më 1464, e që është ndarë në dy degë: Urbino dhe Bergamo, nga e cila kanë dalë 5 kardinalë dhe një Papë (Klemens XI).

Në "Brockhaus die Enzyklopädie - Erster Band, A-AP - Leipzig -Manheim, 1996, fq. 318, Mayers Grosses Personenlexikon - Bibliographisches Institut - Mannheim -Zürich,1968, fq. 26.

NË: Gesamtverzeichnis des deutschsprachigen Schriftums (GV) 1700-1910, bearbeitet under der Leitung von Hilmar Schmuck und Willi Grozny, Cf-Cn,K.G .Sara - München -New-York-London-Paris,1980, Verlag - München, 1980, fq. 421-422, si dhe në shumë enciklopedi të tjera të njohura të botës.

Së fundi, duhet theksuar se familja shqiptare - Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë, që nga ardhja e saj në tokat e Italisë, në vitin 1464 e deri në vitin 1854 (me shuarjen e albanit të fundit), ka qenë dhe mbetet si një familje e shkëlqyer aristokratike -intelektuale në histori, nga gjiri i së cilës familje dolën disa: senatorë, kardinalë, diplomatë, ushtarakë, piktorë, shkrimtarë dhe një Papë, i cili për 20 vjet qeverisi Romën dhe pontifikoi me sukses

Kishën Katolike të saj.

Familja shqiptare - Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë, me anëtarët e saj ishte bërë e njohur dhe e famshme, si familje aristokrate, intelektuale, klerikale dhe e juristëve në zë, sidomos, nga shekulli XVI - XVII dhe XVIII, jo vetëm në Urbino, Bergamo, Venedik dhe Romë, por edhe në mbarë Evropën dhe më gjerë.

Familja shqiptare - Albani, me shkëlqimin dhe autoritetin e saj, që kishte për kohën e vet, do të jetë e shënuar me "shkronja të mëdha" në historinë e krishterimit për vite dhe mote dhe, sidomos, në historinë dhe ndërgjegjen kombëtare të popullit shqiptar.

Sipas botimit: PAPA SHQIPTAR KLEMENSI XI - ALBANI (Gjenealogjia e familjes Albani nga Urbino e Bergamo të Italisë) botim dytë 2024, me autorë EQREM M. ZENELAJ & DOD LULI

Pargatiti: GJON FIERZA

Sa herë vjen 1 Qershori!

KUJDESI NDAJ FËMIJËVE - KRYEFJALË E FAMILJES, SHKOLLËS, SHETIT DHE TËRË SHOQËRISË.
DUKE NDIHMUAR FËMIJËT, NDIHMOJMË TË ARDHMEN!

Kujdesi ndaj fëmijëve është dhe duhet të jetë kryefjalë e shoqërisë. Kanë qenë të suksesshme ato periudha apo ata breza që kanë pasur këtë përkujdesje ndaj fëmijëve, duke filluar nga familja si qeliza bazë e shoqërisë, nga shkolla, e cila ka qenë dhe është vendi ku fëmijët mësojnë dhe edukohen, tek shteti dhe të gjithë institucionet e shoqëria, të cilët asnjë çast nuk duhet ta largoj vëmendjen nga fëmijët, duke parë atje vazhdimin dhe të ardhmen. Asnjëherë nuk është kohë e humbur të merresh dhe të angazhohesh me fëmijët, aq më tepër që ata janë si ai lastar i brishtë, i cili që të rritet i shëndetshëm e të zhvillohet, të ruaj gjelbërimin dhe kur të vijë koha të prodhojë, doemos kërkon në mënyrë të vazhdueshme kujdesin e bukut të mirë dhe të zotë, por dhe të merakosur çdo ditë për ecurinë dhe zhvillimin.

Natyrisht që familja dhe shkolla kanë rolin parësor në këtë edukim dhe mësim, pasi aty fillojnë gjërat, aty hidhen themelet e shëndosha të edukimit dhe të formimit qytetar të fëmijëve, që ata të rriten të shëndetshëm, të edukuar mirë me edukatë e sjellje, me dije e kulturë, me njohuri të thella dhe të gjithanshme për jetën, të sotmen dhe të ardhmen. Gjithnjë është vlerësuar ky fakt, por pak është bërë realisht, dhe, pak bëhet. Ndonëse flitet shumë, ndonëse zotimet për fëmijët janë të pafundme, ajo që bëhet është pak dhe shumë pak, madje në mjaft raste ata dhe kujdesi ndaj tyre i lihen rutinës dhe spontanitetit. Prindi nuk e gjen kohën të merret me ta, sepse ka shumë punë dhe halle të tjera, kur puna më kryesore është edukimi dhe formimi qytetar i fëmijës së tij. Ai kujtohet për fëmijën me raste ditëlindjesh, me raste festash si 1 Qershori, me rastin e vitit të Ri që t'i çojë ndonjë dhuratë, kur fëmija kërkon kujdesin e tij të vazhdueshëm, ashtu sikurse dhe ushqimin që merr për ditë. Apo edhe shkolla që e ka detyrë shtetërore këtë edukimi, mjaftohet në programin mësimor e lëndor dhe fare pak i kushton vëmendje formimit të nxënësve me edukatë dhe sjellje të larta, që do t'i shërbenin për jetën dhe të ardhmen. Një godinë e fortë, doemos kërkon themele dhe konstruksione të forta, sepse themelet dhe konstruksionet janë ato që e mbajnë godinën, që sigurojnë jetëgjatësinë e saj.

Natyrisht që shkolla ka rolin delikat sepse është institucion i specializuar për edukimin he formimin qytetar të fëmijëve, të cilët në shkollë marrin njohuritë bazë të zhvillimit. Aty janë dijet sociale dhe shkencore, aty është edukata dhe marrëdhënia mes njerëzve, aty janë ligjet që mbajnë dhe zhvillojnë drejt një shoqëri të caktuar.

Jeta në shkollat shqiptare rrjedhë dhe gjallëron përditë. Krahas përkushtimit të drejtuesve, mësuesve dhe nxënësve për zbatimin e programeve dhe përvetësimin e dijeve, herë-herë ndodh diçka që qortohet nga mësuesit. Disa nga nxënësit vijnë të papërgatitur në mësim, të tjerë



kanë ardhur pa bërë detyrat ose kanë haruar fletoret në shtëpi, dikush nuk është i vëmendshëm dhe gjatë orës së mësimi hedh vështrimin ëndërrimtar nga dritarja, dikush godet me një shuk letre shokun në krah të tij, dikush tjetër shkaravit mbi tavolinë emrin e sportistit apo këngëtarit të famshëm që ka për zemër etj. Pas mësimi këta nxënës adoleshentë, gjithnjë të zhurmshëm dhe të hareshëm, duan edhe të luajnë pakëz, të argëtohen, të bëjnë edhe ndonjë shaka, të tregojnë një anekdotë. Por, diku ndodh edhe ndonjë grindje apo sherr i mprehtë, një zënkë që nis si me shaka dhe shndërrohet padashur në një konflikt të rëndë dhe të rrezikshëm. Madje ndonjëri nga jashtë oborrit të shkollës, kërkon të bëjë fortin dhe, ai dëshiron të dallohet nga të tjerët, të jetë ndryshe dhe original në mendimet, fjalët dhe veprimet e tij. Ai kërkon të zbulojë rrugët që i duken të drejta për të qenë sa më interesant në jetë, të tërheqë vëmendjen e të tjerëve drejt tij. Pa këto zhurma të hareshme nuk mund të kuptohet dot jeta e adoleshentve. Nëse do t'i kthehemi realiteteve të shkollës, pas emrit të çdo nxënësi, pas numrit rendor në regjistër, pas çdo note, është një fëmijë me botën e tij shpirtërore në formim, i brishtë, që ka nevojë të orientohet, të nxitet e të mësojë, paçka se ai për veten e tij thotë se "i di të gjitha dhe s'ka asgjë për të mësuar". Por ai ndihet keq kur ndjen indiferentizëm ndaj tij, kur nuk e përfillin dhe nuk tregojnë interes për të. Ai ndihet keq kur nuk di se ç' të bëjë, kur nuk ka motive në jetë. Në kësi rastesh për fëmijët, një ditë nuk ndryshon

nga një ditë tjetër, një muaj nuk ndryshon nga një muaj tjetër: "

Ah, gjithnjë të njëjtat gjëra! Sa ditë të mërzitshme!" Nxënësi

tadoleshentë fillojnë e bëhen melankolikë, mbyllen në vetvete, bien në pesimizëm e, gjer në dëshpërim të thellë. Dhe ky është çasti më i rrezikshëm, sepse ata përpiqen të gjejnë ngushëllim dhe zgjidhje, duke hedhur vështrimin nga rruga, që i tërheq si "gjarpër i keq". Lexo po deshe hartimet e çiltra të disa prej këtyre adoleshentëve. Aty ata rrëfehen, aty shprehin diçka nga zjarri i shqetësimeve që i djeg përbrenda shpirtit, aty sheh se si ata përpiqen e përpëlitën pa mundur të gjejnë gjithnjë rrugët më të drejta të jetës. Nuk them se këta adoleshentë duhet të mbahen për dore. Jo. Këtë ata nuk e pranojnë, ndihen të fyer, por gjithsesi, ata duhen orientuar, duhen ndihmuar të kapërcejnë gjendjen e stresit dhe të rënduar psikologjike. Ata duhen shkundur, duhen vënë në lëvizje, duhen hedhur në veprim. Në shkollë është vendi ku duhet të edukohen ndjenja dhe të nxiten ëndrra të bukura, është vend ku hedh shtat personaliteti i adoleshentit, ku ai orientohet drejt së bukurës dhe së mirës, së drejtës dhe progresives. Shkolla ka rolin e saj të padiskutueshëm dhe parësor në ndryshimin e gjendjeve dhe përsosjen e realitetit ku jetojmë.

Është forca e arsimit dhe e kulturës që shpërndan mjegullën dhe errësirën, prapambetjen dhe injorancën, që i kundërvihet së keqes dhe ligësisë, që mbron të drejtat e adoleshentëve nga dhuna dhe arbitrariteti...Duke u ndodhur përballë

vështirësive, duke ngritur nivelin e punës së saj, shkolla të përdorë edhe ajo "armët" e reja të kohës moderne për të qenë e aftë të fitojë mbi sfidat, dukuritë negative, të ndikojë së bashku me shoqërinë dhe shtetin dhe të "ndërhyjë" bashkërisht që t'i shpëtojnë adoleshentët nga e keqja, të vihet në krye të veprimeve të fuqishme humanitare ... E përbashkët është se, të gjithë kemi qenë dikur nxënës dhe si të tillë nëpër vite bëjmë vlerësime dhe shfaqim opinione për mësuesit tanë. Ata qëndrojnë në mendimet dhe përfytyrimet tona si njerëz të afërt, kujtimet për ta na bëjnë që të ndjehemi mirë, na bëjnë që të na vërshojnë emocione dhe mbresa të shumta, tekta malli dhe buzagazi na rrëshqet ëmbël në fytyrat dhe në sytë tanë. Nuk e di pse ndodh kjo me mësuesit? Mbase, sepse të gjithë kemi marrë diçka prej tyre në formimin tonë, në shprehitë dhe zakonet tona, diçka që fillon që nga mënyra se si përshëndetemi, sesi respektojmë dhe duam njëri-tjetrin dhe jetën, nga mënyra se si nisim dhe zhvillojmë një bisedë si zgjidhim një problem, si futemi në botën e mrekullueshme dhe të mistershme të dijes...

Janë mësuesit të parët që kapin prirjet e nxënësve dhe kujdesen vazhdimisht që ato të nxiten dhe të zhvillohen më tej. Se talenti nuk zhvillohen vetvetiu, por kërkon një mjedis përkrahës ashtu si fara, e cila që të shndërrohet në bimë, kërkon kushte të caktuara klimaterik-tokësore, kërkon shërbim, ngrohtësi e përkujdesje. Dhe, jo vetëm muaji i letërsisë, por edhe çdo orë tjetër e mësimi

Kur nota zëvendëson dijen, një krizë e heshtur në shkollim



MANUSHAQE HOXHA LAÇI
Mësuese kimie në gjimnazin
"Skënderbeu" Krumë, Has

Në një kohë kur teknologjia dhe informacioni janë gjithmonë më afër nesh, shkollimi po përballlet me një krizë të heshtur, por të thellë. Dija po zbehet, ndërsa nota po mbivlerësohet. Me fjalë të thjeshta, nxënësit po përdorin teknologjinë jo për të nxënë, por për të marrë vlerësime maksimale. Kjo e ka kthyer shkollimin në një sistem ku dija realisht zëvendësohet nga kërkesa për të marrë pikët më të larta.

Në dukje, teknologjia i ka lehtësuar shumë gjëra nxënësve: çdo informacion është një klikim larg, përmbledhjet janë të gatshme në internet, zgjidhjet e ushtrimeve janë në platformat si YouTube, TikTok dhe aplikacione si Photomath. Megjithatë, lehtësia e rezultatit nuk është e barabartë me kuptimin e thellë dhe këtu nënkuptohet problemi kryesor.

Sot, shumë nxënës e përdorin teknologjinë për të kopjuar, për të marrë përgjigje të gatshme apo për të ndërtuar ese që nuk i kanë shkruar vetë. ChatGPT, Google dhe aplikacione të tjera janë bërë mjete për të kaluar nëpër provime, jo për të zhvilluar mendjen. Nxënësit kërkojnë përgjigjet e duhura për të marrë pikët, duke shpërfil-

lur thelbin e mësimit dhe pa e kuptuar të vërtetën që fshihet pas përgjigjeve.

Ky është një shembull i dukshëm i shkollimit për nota, jo për njohuri. Të rinjtë janë më të fokusuar te rezultati përfundimtar sesa në rrugën që duhet të ndjekin për ta arritur atë. Si pasojë, dija nuk përvetësohet dhe shpesh harrohet menjëherë pas testit. Nuk ka asnjë përpjekje për të thelluar njohuritë, vetëm për t'i marrë ato sa më shpejt dhe më lehtë.

Kjo situatë nxit një mësim të shpejtë dhe mekanik. Pjesa më e madhe e nxënësve nuk mësojnë më për të fituar një kompetencë të vërtetë, por për të kaluar provimet. Një shembull i thjeshtë mund të jetë eseja e letërsisë që shumë nxënës e kopjojnë nga interneti, pa lexuar fare tekstin e kërkuar. Ky nuk është vetëm një problem etik, por një kushtim për funksionimin e sistemit tonë shkollor.

Për më tepër, dija është kthyer në një mjet për të arritur nota, dhe jo një burim zhvillimi personal. Maturantët, që marrin nota të shkëlqyera shpesh nuk janë në gjendje të shpjegojnë konceptet bazë të lëndëve, sepse gjatë gjithë kohës kanë qenë të përqendruar tek strategjitë për të marrë pikë, jo për të kuptuar thelbin e lëndës.

Teorikisht, teknologjia mund të jetë një aleat i fuqishëm për të ndihmuar mësimin. Kur përdoret në mënyrë të mençur, ajo mund të inkurajojë nxënësit të eksplorojnë thellë një temë, të krijojnë projekte ose të mësojnë në mënyrë të personalizuar. Por kur përdoret vetëm për të shmangur përpjekjen mendore, ajo e dobëson atë, që shkollimi duhet të forcojë: aftësinë për të menduar.

Në thelb, sistemi ynë shkollor mat më shumë çfarë dinë nxënësit përkohësisht, sesa janë të aftë të kuptojnë dhe të për-

dorin atë që mësojnë. Ky është problemi kryesor: nota ka marrë rolin kryesor, duke e shtyrë dijen jashtë skenës.

William Butler Yeats, thotë: "Shkollimi nuk është mbushja e një ene, por ndezja e një zjarri." Pra, në sistemin tonë shkollor, dhe jo vetëm, po përjetojmë një krizë të heshtur. Dija po humbet vlerën e saj reale, ndërsa nota po vendoset në qendër të gjithçkaje. Nxënësit mësojnë për provim, jo për të kuptuar; për të marrë 10-ën, jo për të ndërtuar të ardhmen e tyre mbi themele të sigurta.

Në këtë mënyrë, shkrimi i përmendur më sipër është shumë i rëndësishëm për të kuptuar që dija është shumë më shumë se informacioni që memorizohet për një test. Ajo është aftësia për të kuptuar, për të menduar kritikisht, për të lidhur koncepte dhe për të parë botën në mënyrë të thelluar. Megjithatë, kjo lloj dijeje ende nuk vlerësohet si duhet.

Nxënësit shpesh ndihen të detyruar të përqendrohen në formularë, përmbledhje dhe struktura që mund të garantojnë nota të larta. Kjo nuk ndodh sepse ata nuk janë të aftë të mendojnë thellë, por sepse sistemi nuk u ofron mundësinë, hapësirën dhe vlerësimin për të bërë një gjë të tillë.

Nota ka marrë një rol të pashmangshëm, dhe është bërë një qëllim në vetvete. Ajo përcakton gjithçka: pranimin në universitete, bursat, vlerësimin nga mësuesit, dhe shpesh edhe respektin në familje. Ky fenomen është më i dukshëm në provimet e maturës shtetërore, ku një rezultat mund të përcaktojë fatin e një të riu, pavarësisht potencialit të tij të vërtetë.

Por ka gjithashtu mundësi për ndryshim. Disa mësues, shpesh të veçuar, punojnë jashtë kornizave tradicionale, duke inkurajuar projekte, kërkime dhe disku-

time kritike në klasë. Edhe pse disa nxënës nuk kanë qenë të shkëlqyer në nota, ata kanë arritur suksese të jashtëzakonshme në fushat e teknologjisë, artit dhe ndërmarrësisë, shpesh përmes formave alternative të të mësuarit si kurset online, praktikat dhe vetë-studimi.

Një model i njohur dhe i suksesshëm është ai i Finlandës, ku nxënësit nuk testohen masivisht, por vlerësohen gjatë gjithë vitit në mënyrë individuale. Mësuesit kanë lirinë për të përshtatur mësimdhënien, dhe vëmendja përqendrohet te procesi, jo te rezultati përfundimtar.

Për të ndryshuar këtë realitet, është e domosdoshme të:

Rishikohen mënyrat e vlerësimit dhe të orientohen më shumë drejt aftësive analitike dhe krijuese.

Edukimi i përdorimit të teknologjisë duhet të bëhet me qëllimin që ajo të mbështesë procesin e të nxënësve, dhe jo ta zëvendësojë atë.

Kultura e vlerësimit të dijes duhet të ndryshohet, duke i dhënë vlerë përmbajtjes dhe jo thjesht numrit të notës.

Zbutja e peshës së notës veçanërisht në provimet përfundimtare.

Diversifikimi i formave të vlerësimit, përfshirë projekte, ese, debate dhe punë praktike. Inkurajimi i mësimit të bazuar në kërkim dhe zgjidhjen e problemeve.

Trajnimi i mësuesve për të mbështetur mendimin kritik, sesa riprodhimin e fakteve. Ndërgjegjësimi i prindërve që të mos e barazojnë notën me vlerën e fëmijës.

Për mendimin tim personal më kryesorja është zbutja e peshës së notës së provimeve përfundimtare dhe ndërgjegjësimi i prindërve që të mos kërkojnë nota të pamërituara për fëmijët e tyre.

Nëse duam të ndërtojmë një shoqëri që mendon, krijon dhe inovaton, nuk mund të vazhdojmë ta mbysim dijen me numra. Nota mund të hapë një derë, por është dija ajo që të mban brenda. Dhe ndoshta është koha jo për të pyetur: "Çfarë ke marrë në provim?". Pra, "Çfarë ke kuptuar?".

duhet të bëhen nxitje për ata nxënës, të cilët shfaqin prirje dhe ide krijuese. Të vihen në lëvizje energjitë krijuese të fëmijëve. Ato ekzistojnë, janë të fshehura dhe të struktura brenda tyre, ato duhet të zgjohen, të vihen në lëvizje, të trokitet në to: "Hej, djalosh, zgjohu! Mos fli gjumë! Jeta është e bukur, shiko, hap sytë, hidhu edhe ti në vrullat dhe dallgët e jetës, lëviz, përpiku, mundo-hu, përlshu me të keqen, kapërce majën dhe ec përpara, vazhdo ngjitjen, ke maja të tjera përpara për të kaluar. Tek përballimi i këtyre vështirësive, te kapërcimi i tyre qëndron bukuria e jetës. Kështu, aftësitë, talentet e nxënësve nuk kalojnë si hije, pa u ndjerë dhe pa u vënë re, pa mundur të tregojnë aftësitë dhe talentin e tyre... Këtu, mësuesi është kultivuesi, është regjisori më i mirë dhe më i talentuar. Janë të shumta fushat ku mund të veprohet, ku mund t'u hapen horizonte adoleshentëve dhe jeta e tyre të motivohet, të marrë vlerë dhe kuptim. Natyrisht jo paternalizëm, jo diktim i ideve, por nxitje, krijim i një atmosfere dhe kushteve të përshtatshme që fëmijët të zgjedhin vetë më të mirën, më interesanten dhe më të bukurën për ta dhe të veprojnë. Atyre nuk

mund t'u mohohet zhvillimi i natyrshëm i jetës. Nuk u duhet "vlarë" fëmijëria dhe rinia, ata duhet ta jetojnë jetën natyrshëm, pa sforco e mundim, nuk duhet t'u diktohet se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë s' duhet të bëjnë, por t'u tregohet e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara nëpërmjet veprimeve, ndodhive, debatare, ballafaqimeve... Ata duhen nxitur, duhen hedhur në veprim me forcën e fjalës, të ideve, të mendimit të mençur. Në kujtesën e nxënësve mbahet mend mësuesi që i nxiti, që u ngjalli besim, që u hapi horizonte të reja për një drejtim të caktuar, zbuloi dhe nxiti pasionin që ata mbanin të fshehur në shpirt e zemër, ata kanë mall dhe respekt, sepse i dedikojnë mësuesit të tyre deri edhe të ardhmen...

Ja sesi si shprehet një nxënëse për mësuesin e saj të letërsisë: "Të zhvillosh orën e mësimit të letërsisë, do të thotë të udhëtosh në botën e rikrijuar nga ne me petkun e fantazisë. Të fluturosh në lartësitë më të mëdha marramendëse, të jesh i lumtur, të ndjesh freskinë e ujërave të lumënave, të luleve të bukura, e të kapesht realen. Nuk është vetëm një ëndërr, është thjeshtë një orë e nxitur nga mësuesi, që shfrytëzon thellësitë e moshës tonë për të

na struktur në gjirin e letërsisë e në tërë skutat e fshehta e të mrekullueshme të saj. Dhe, të gjitha këto, do të doja t'i mblidhja, t'i lidhja në fjonço dhe t'ia dhuroja mësuesit tim". Dhe në qendër ka qenë dhe mbetet figura e nderuar e mësuesit, e këtij udhërrëfytyrës të shkëlqyer të dijes dhe përparimit. Prandaj dhe mësuesi mbetet gjatë gjithë jetës i fiksuar në mendjen dhe kujtesën e nxënësve.

Me aftësi, takt e durim, mësuesit dinë ti marrin fëmijët, nxënësit e tyre ashtu si janë dhe punojnë pa reshtur e pa u lodhur për skalitjen e mendjes së tyre, për pajisjen me dije të thella mbi botën dhe shoqërinë njerëzore.

Mësuesit ndihen të nderuar dhe të obliguar kur drejtoria e shkollës, mësuesit apo dhe vetë nxënësit i ftojnë për takime dhe bashkëbisedime dhe kërkojnë ndihmën e tyre për problemet që preokupojnë. Ndaj shkollës jemi të ndjeshëm dhe i detyrohemi të gjithë, prandaj t'i afrohem shkollës, jo vetëm kur na thërret drejtori apo mësuesi kujdestar për fëmijën që është mbetës, rrezikohet të përjashtohet për shkak të mungesave të shumta, por të jemi atje sa herë që shkolla ka probleme dhe gjera për të zgjidhur. Sikurse, drej-

toria e shkollës, mësuesit i kanë të gjitha hapësirat e nevojshme që tu drejtohen hapur dhe pa droje prindërve të nxënësve, specialistëve, njerëzve të artit e të kulturës, biznesmenëve. Ata ndihen të nderuar dhe të obliguar kur drejtoria e shkollës, mësuesit apo dhe vetë nxënësit i ftojnë për takime dhe bashkëbisedime dhe kërkojnë ndihmën e tyre.

Duke ndihmuar shkollën, ndihmojmë fëmijët të sotmen dhe të ardhmen e tyre. Shumë mësues kanë qenë të suksesshëm që me taktin, kulturën pedagogjike dhe horizontin e gjerë, kanë arritur të zgjojnë ide, energji, pasione dhe dëshira tek nxënësit: Ata mësues human e zemërgjerë, që u qëndrojnë pranë nxënësve, ashtu si fëmijëve të tyre, që zbulojnë prirjet dhe ndihmojnë të motivojnë jetën e nxënësve, që "mjekojnë" gjendjen e tyre të stresit dhe zgjojnë shpresa dhe besime të reja. Vetëm kështu afrohem më shpejt qytetërimit evropian e më gjerë.

Duke ndihmuar shkollën dhe mësuesit ndihmohen fëmijët dhe të rinjtë, që janë e sotmja dhe e ardhmja e vendit.

FRAN GJOKA

MALO BEK SHKRELI: MBI TOKËN E HUAJ, NËN FLAMUJT E TË HUAJ

(Ese Tragjike shqiptare)

Në male të Shkodrës, aty ku era rrahë me duhi, rrufeja gjarpëron ndër lisa dhe ortiqet tundin dheun, pati tabanin e moçëm Malo Shkreli, burrë me gjoksin si shkëmbi, me sy që s' ulnin vështrimin para askujt. I heshtun që shihte punën e vet, nuk ngucte as kënd, as nuk duronte me u prekë sa qimja. Ia patën vra tatën te ama e mullirit.

Ishte çelja e diellit, të mes gushtit Sadri Shkreli atë ditë kishte redin e vadës, toka ishte tha e ba kaf dhe bimët velmë më të ardhë gjynah më i pa me sy. Arif Metës i shkrep mendja me blue një koshiq drithë. Ujtë e mullinit verës përdorej për vadë jo me blue. Vetëm ai që kishte redin e vades mund të bluante apo t'ia jpte me mirëkuptim, për ndonjë nevojë të ngutshme.

Arifi tue ditë se komshiu i tij, që po lunte shatin në are i'a preu ujtë dhe lëshoi mullinin...

Sadria i mbetun gafil si peshku në zall mori shatin në krah, me pa vijën se ku asht nda ujtë. Kur shkoj te ama e mullinit pa se uji ishte nda me dashje prandaj i dha drejtim për në arë. Mullini prani blojën, por Arifi u kall flakë, mori hutën dhe shytoi me thumb të palue pa jetë Sadri Shkrelin. Uji i përskuqun vërshoi drejt në arës, por Sadria, nuk vaditi kurë ma!

Mala ende pa vu brisk në fytyrë, kur pa babën pa jetë mori karajfilen e gjatë dhe mori gjakun dorë për dorë.

Në potër me gisht në gacëkeqë, doli edhe Man Arifi, trimi çartun i ati. Gjuajti me thumb dhe i ra në nofull e majtë Malo Shkreltit, që u rrezua dhe u shtir sikur ra pa frymë. Sa mbushi pushkën për se dyti Mani për t'i dhanë goditjen fatale, një plumbi tue fishkëllye iu rrapangjesh në mes të dy vetullave...

Mala iku e u strehua në Tophanë te një dyfek punues probatin i babës. Kullën shtëpinë dhe gjithë mallin i lëshoi nën gjak dhe nuk u duktë kurrë ma në Shkrelt...

Në një kohë kur Turqia kërkonte luftëtarë të guximshëm, Mala, i njohur për guximin dhe forcën e tij, hyni në vallen e luftërave dhe u ba ushtar i Dauleti. Pushka i shpërthente me fat, ndërsa trimnia i shkëlqente në mes të fushave të mbushuna me gjak. Për trimërinë dhe meritat ushtarake, ai mori gradën "bylykbash", dhe i gjithë Tophana e nderonte dhe e thërriste me emrin Malo Degu.... Si trimalosh e thirrën me shkue në Çanekala. Jo se deshti, por nuk mund i binte mohit gradave, mishit dhe bakllavës, që bujarisht ia kishte dhanë Stambolla. Si zabit tagërmbledhës në Babunë, Tivar e Ulqin, sipas parimit të njohur dy për veti një për hyqymetin, kish ble dyqane, toka e grumbullua para...

Ishin kohë të zymta, Shqipnia sa kishte nda hisen e diellit të vet, por askush nuk besonte se mbahej në kambët e veta. E

shkreta hallemadhe ngjate si dele prej gëlbazave mes çakejve të uritun, ku gjithsecili kërkonte të shqyente nga një kaçik të saj.

Era e luftës ulërinte si bishë e plakun. Austria kish hy në Shkodër, Serbia mbante Kosovën, por edhe në Dibër e Mati. Çamëria digjej e piqej prej grekeve. Italia kontrollonte portin e Durrësit dhe bregdetin Adriatik. Francezet kishin hy në Korçë. Shqipnia s' ishte veç një emër, që nuk mjaftonte të për kënaqë orekset e të huajve...

Nostalgjia e vjetër e shtyni të nisej. Paj ma mire, thoshte me vete një Shqipni nan Turki se sa e ndamë copa- copa si kulaçin në hi...

Çenakala, rrafshnalta e djegun nga dielli, mbante në ajër erën që sillte taftin e vdekjes. Toka e plasaritun nga vapa e priste të vaditej, por jo nga uji, po nga gjaku. Kodrat ishin zhveshë, pishat tha; ndërsa qielli i përflakun nga flakët, dukej si flamur i zhytur në gjak. Austriakë, gjerman, turq, e shqiptarë Sa shumë!

Sa shumë shqiptarë, 25 000 vullnetarë nga Presheva, Kumanova, Shkupi, Manastiri, Ohri, Peja, Gjakova, Shkodra, Vlora dhe Elbasani, të mbledhun nën komandon e Mustafë Kemal Atatürkut, një udhëheqës i njohur që drejtonte Divizionin e 19 të redifëve arnautë.

Në këtë rrafshnaltë, heshtja fliste më shumë se çdo fjalë. Një turmë i madhe luftëtarësh, që kishin lënë gjithçka pas për të luftuar, po për çfarë vallë?!

Ishte një përpjekje kolektive, lojë e tmerrshme lufte. Dita ishte një thikë e nxehtë, e shtrirë mbi trupat e aktorëve, që luftonin nën një qiell të përflakur, që nuk e kursente asnjë njeri. Forcat shqiptare -turke e austro-hungareze përpiqeshin të mbronin pozitat e tyre, përkundër sulmeve të pamëshirshme nga aleatët anglo-francezë dhe rusë.

Malo Shkreli, me çetën e tij vallëzonte mes llavës përvëluese. Topat britanik shkrepnin pa mëshirë, çdo predhe i merrte një emër, një shok një kujtim një jetë. Në mbramje, kur qielli u nxi e toka s' dallohej prej resë së tymit, Malo Shkrelit iu rrezuan para syve si lisat trupat e shkove Isuf Uka, Ali Puka, Hamit Gashi, Halil Hotit, Rexhë Kosva e 2 500 kësula, pa krena. Ranë si trima të pa pamë të shtrimë për dhe, me sy kah qielli sikur, kërkonin edhe njëherë Shqipërinë.

Aty Malo beg Shkreli u shkëput, jo nga beteja, por prej vetës. Ra në gjunjë, me pushkën në dorë e shikimi i tij u tret në horizont. Çka po ban këtu bre Tahir Begu?! Pse po derdhë gjakun për një tokë që nuk asht e jotja e për një mbretni, që se din se kush dreqi ti? Shkodra ime asht nan çizmen e të huaj. Shqipnia e ndame copë - copë. Kosova e përgjakun, Çamëria po zbrazët krejt, e unë ... jam n' Çanakal-në e dreqit të mallkuem. Jam në tokën e Sulltanave, që e mbajtën djepin ku linda

5 shekuj nan zgjedhë. Na joshën mua e te tjerë si unë, me nga një nishan, na banë qefin si fëmijët me nga një lodër "Karatash", me të cilat luftuam kryq e tërthorë, për Sulltanat, por jo për atdheun e robëruam tua harrua amanetet e Gjergj Kastriotit, Lekë Dukagjinit dhe fatosave që i falën gjakun Arbrit.

Gjithë jeta dhe trimëritë e tij pa bereqet i kaluan në reviste para syve që iu mbushën më lot, por nuk qau. Ishte një copë shkëmbi shqiptarë që një ortek i rrëmujshëm e solli këtu mes zjarrit. Tash ai asht skuqë e ba gacë.

- Ma mirë me vdekë e me u tretë, se me jetua si vegël e hua ...

Lufta u ndez kur dielli mezi çelte dritën nëpër re të përzhituna. Në ajër, aroma djegës e barit dhe e pluhurit të tokës së përgjakur mbushte çdo frymëmarrje, ndërsa në distancë mund të dëgjoheshin tingujt e zhurmshme të armëve të luftës, që thyenin heshtjen. Pushkët e vjetra, të mbështjella në pluhur, ishin gati për të shpërthye. Toka gjëmonte prej topave, gjethi ndizej flakë prej vetëtimave. Malo bek Shkreli me jelekun e zbërthyer me gjoksin e mbuluem me pluhur e gjak, doli para çetës. Kush, ka vdekë i lehtë i qoftë dheu! Kush asht trim le të sulet përpara. U turr e u hodh drejt zjarrit.

Flakët e artilerisë nuk e dogjën, por ai nuk ndaloi. Britma e tij çau fushën. Për

nderë jo për Turki! Rrëzimi i tij nuk kje as ulje as rënie, por si bredh, që e çanë rrufeja, por rrënjët i ka thellë në shkamb. Ra me sy kah perëndimi, kah Shqipnia, por nuk e pa ma. Fytyra e tij e ngurtë si faqe e malit të shkretë.

Gjaku i njomë rridhte mbi tokën e huaj, duke lënë pas vetes një shenjë të pashlyeshme. Tagani, i përgjakur, mbante tingujt e dhimbjes, që vinin nga thellësia e shpirtit, ndërsa huta, e mbushur me heshtje, mbeti pa krye.

Zemra nuk ndali, por plasi, tu shpërthye në një hidhërim të pafund. Malo beg Shkreli nuk iu gjet varri, por emri i tij u bë një gjëmë, që kaloi nga goja në gojë, një këngë e ngrirë në kujtesë, që do të tingëlonte përjetësisht.

Plakat e Shkodrës e vajtuan si djalin që s'u kthye.

Djelmnia, që shpëtoi e zhytun në trisht, thotë: Aty mbeti Malo Bek Shreli, për një tokë, që s'ia njihte emrin, por me mall të një toke që nuk e mbrojti.

Mos e lëvdoni për trimërinë, pa e kuptua dhimbjen që la.

Mos këndonin këngë, pa ditë kujt ia dha jetën.

Të mësojmë nga gabimi fatal i tyre, jo çdo pushkë është, për t'u shkrepë!

Jo çdo luftë asht për me u fitua!

Jo çdo flamur duhet me u nderua!

PRELË MILANI



A ku ka ma mirë se për gruan shqiptare!

JA DISA NGA MENDIMET E TË MËDHENJVE TË KOMBIT ÇFARË KANË THANË PËR GRUAN SHQIPTARE

“... i kemi mbetur borxh grues, vajzave e nënave shqiptare. Duhet të shkruajmë për to. Ato kanë luajtur një rol të madh në shoqërinë shqiptare. Vetëm një nanë shqiptare, një nanë malësore mund të rrisin fëmijë kaq të fortë e me kaq cilësina”

Dom Frano Ilia

“Në kombin tonë, duket se tërë hollësia e mendjes dhe e zemrës, tërë bukuria e karakterit dhe sjelljes, kanë rënë në anën e gruas.”

Faik Konica

GRUAJA SHQIPTARE NË VËSHTRIMIN E TË TJERËVE

Një libër disi ndryshe prej të tjerëve, pak i njohur për lexuesit, i botuar më 2012, por që mu mbush mendja t ju a bëj të njohur miqve dhe dashamirësve të mijë. Nga se jam nisur për botimin e këtij libri? Kjo pyetje më është bërë gjithnjë pas botimit të çdo prej librave të mijë. Do të përmend vetëm një shprehje që Ana Di Lellio., sociologe italiane, ish komisionere për mediat në Kosovën e pasluftës, që do të shprehej, për t'i bërë të njohur botës atë çfarë ato nuk dinin për trimëritë e gruas kosovare: “Të gjithë e dinë se kush ka qenë Adem Jashari, por askush nuk di se kush ka qenë gruaja e tij dhe si e ka pasur emrin, askush nuk flet për këtë grua, për Adilen, e cila në kohën kur Ademi po luftonte ajo barte municione, nga një vend në tjetrin dhe luftonte.

Dhe do të vazhdonte më tej, për t'i bërë të ditur Perëndimit, se çfarë bëjnë gratë kosovare:

“Gratë kosovare kanë qenë pjesëmarrëse në demonstrata, kanë protestuar në rrugë, kanë luftuar në radhët e UÇK-së, kanë qenë në politikë, ato nuk i ka ditur Perëndimi dhe askush nuk i ka treguar”

Ja dhe qëllimi i këtij botimi: për të evidentuar dhe për t'i bërë të ditur jo vetëm opinionit të huaj, por edhe atij vendas, që historia e gruas shqiptare nuk ka kaluar pa u vënë re, pa u vështruar nga të tjerët, pa u shkruar dhe pa u studiuar jo vetëm nga vendasit, por shumë edhe nga të huajt. Do donim të dinim më shumë, më thellë, por aq sa arritëm të evidentojmë ato që u shkruan për gruan, duke treguar të mirat dhe dobësitë e saj, heroizmin e saj në luftë, karakterin si nënë, si grua, si bashkëshorte, si motër dhe më e veçanta si shqiptare, si ruajtësja më fanatike e gjithë atyre zakonëve që trashëgoi populli ynë, do të jetë ndoshta hapi i parë në këtë fushë studimi. Shumë prej vetive të saj i kanë përshkruar studiues dhe albanologë të huaj, udhëtarë që kaluan me shekuj nëpër viset shqiptare, etnologë, shkrimtarë, poetë, që në faqet e librave të tyre treguan çfarë panë, për gruan, çfarë u bëri përshtypje, karakteri apo gjendja sociale, pozicioni shoqëror apo veshja kombëtare, bukuria shpirtërore apo edhe ajo fizike. Shpesh nuk u pëlqeu pozita skllavëruese që mbante shoqëria, sistemi, familja, normat kanunore ndaj tyre, nuk i pëlqente veshja me perçe, apo kur i shihnin duke mbajtur barra të rënda drush, duke i skllavëruar burri, dhe ashtu i shkruan duke dhënë edhe opinionet e tyre. U bënte përshtypje që në historinë e Shqipërisë, që në kohën e ilirëve gruaja shqiptare kishte luftuar krah për krah

me burrin, që ishte vetëflijuar për fëmijët e saj për të mos rënë në dorë të armikut, gjë e rrallë për popujt tjerë, dhe pastaj do të mrekulloheshin me veshjet e tyre kombëtare që ndryshonin nga krahina në krahinë, me bukurinë fizike që se kishin hasur në gratë e vendeve të tjera.

A është studiuar historia e emancipimit të gruas shqiptare mbi baza të thella shkencore në vite?

Këtë jam përpjekur ta jap në pjesën “Gruaja shqiptare në veprat e studiuesve dhe...”, por pa pretenduar se është arrite plotësisht gjithçka. Ka filluar me Sami dhe Naim Frashërin, duke dhënë në veprat e tyre edhe rrugët e zhvillimit të saj shoqëror, arsimor dhe intelektual nën shembullin e vendeve më të zhvilluara të Evropës dhe Amerikës. Mithat Frashëri ka dhënë në librin pamflet “Plagëtona” shkaqet dhe rrugët për zhvillim dhe emancipim, duke e bërë vetë gruan protagoniste, subjekt dhe objekt të zhvil-

Nanat me qumësht t'pastër andjen e shpirt t'ondiktojshin

Me fluturue si shqipe në qiell t'nderit shqiptar

N'flak t'dokeve m'u knellun e n'zjarm t'buzmit bujar

Qi kobin e zvetnimit nga votra na e largojshin

Ernest Koliqi (Shejzat)

“Gruaja na robëron me dobësitë por jo me vullnetin e saj. Sa ma pak fuqi të duket se ka gruaja, aq ma tepër siprëri ka mbi ne”

Mithat Frashëri

limit të saj. Pastaj studiues më të rinj, të mëvonshëm, kanë treguar për rrugët që kaloi emancipimi i saj, pozita në shoqëri, kanune, legjislacionet shqiptare, në marrëdhëniet martesore, bashkëshortore, për veshjet e saj, për traditat, këngët, poezinë e tjerë.

Po në penën e shkrimtarëve dhe poetëve si ka qenë roli i gruas, si i ka frymëzuar, si është trajtuar? Kjo temë është trajtuar në kapitullin “Gruaja shqiptare në veprat e shkrimtarëve dhe poetëve”. Janë me dhjetëra shkrimtarë dhe poetë të huaj dhe vendas që gruan e kanë jo vetëm në qendër të krijimeve të tyre, por edhe në shumë role episodike, ku ajo luan role të veçanta. Herë romantikë për dashurinë ndaj saj, herë sentimentale ndaj bukurisë dhe ndjenjave të saj, ato, në shumë raste e veçanërisht në drama kanë shprehur edhe revoltën e thellë ndaj sistemit që e kishte lënë gruan në pozitën më të vështirë shoqërore të historisë saj. Dhe kjo

kryesisht në veprat që datonin para vitit 1944, ku autorët e kishin më të lehtë të shprehnin qëndrimet e tyre ndaj sistemit. Mbas viteve 1944 ku sistemi e fut letërsinë në kornizat e realizmit socialist, ku rolin kryesor e kishin heronjtë pozitivë të veprave të tyre që në shumë raste ishin edhe gratë, jepej lufta e tyre për emancipim dhe zhvillim në prizmin marksist, duke përshkruar kryesisht edhe fitoret e arritura në këtë fushë,

Mbas viteve 1990 gruaja në veprat e shkrimtarëve, por edhe të studiuesve paraqitet në kondita të tjera përsëri të vështira, duke luftuar për një identitet të ri, aty ku po fillonte ta fuste sistemi i ri demokratik. Tashmë ajo ballafaqohet me humbje dhe rimarrje të identitetit, me emigracionin, me dhunën në familje, prostitucionin dhe trafikimin, drogën e të tjera, që do ta vejnë atë në sprova të vështira.


Në pjesën “Gruaja në veprat e biografëve dhe si autobiografe” jepen shumica e librave ku autorë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj kanë shkruar në formën e monografive, biografite e grave më të shquara të vendit tonë. Por ka dhe autobiografi ku vetë gratë kanë shkruar për jetën e tyre. Dhe ndoshta nuk janë aq por më shumë, e ky studim duhet të vazhdojë.

Nuk pretendoj se, me këtë libër kam bërë gjithçka, por me anë të tij dua të tregoj se, sa ka qenë në vëmendjen e shoqërisë shqiptare dhe të huaj gruaja shqiptare, duke sjellë në vëmendje ato çfarë unë arrita të përfshij. A ka përsëri të tjera studime, shkrime monografike, autobiografike, romane, poezi për gruan shqiptare? Pa tjetër që ka më shumë dhe të tjerë do të arrijnë të zbulojnë, të hulumtojnë dhe të tregojnë shumë gjëra të tjera për ato se çfarë i përkasin gruas shqiptare. Është kjo arsyeja që unë pres edhe vërejtje konstruktive për këtë vëllim për të përmirësuar gjithçka që mund të bëhet më mirë.

Mendoj se ky libër do t'i shërbejë kryesisht brezit të ri, nxënësve dhe studentëve, shoqatave, jo vetëm të grave, studiuesve të rinj, për të parë në mënyrë të koncentruar, si vështrohej gruaja shqiptare nga të tjerët, ku ishte vendi i saj në shoqëri që nga koha e lashtësisë ilire, kush shkroi për te dhe si analizoi burrërinë, heroizmin, feminitetin dhe bukurinë, thjeshtësinë, moralin dhe traditën e saj.

Mirë do ishte që ky libër të ishte edhe i përkthyer edhe në anglisht që ta merrnin vesh edhe të tjerët kush ishte dhe kush asht gruaja shqiptare. Por na falni se lekët na duhen për zgjedhje dhe as që e ve kush ujën në zjarr për të tilla botime.

Dr. ZENEPE DIBRA



Dr. Skënder Demaliaj promovon 20 libra nga fusha të ndryshme

Para pak ditësh në një veprimtari në Tiranë "Internacional Hotel", në formë ekspozite Dr. Skënder Demaliaj promovoi 20 libra, që ka botuar ndër vite.

Në një sallë të bukur, funksionale, të standardeve bashkëkohore për veprimtari të tilla, me një foni të shkëlqyeshëm, të gjitha falas, pa asnjë lekë nga biznesmeni bytyças, Ramë Geci, i cili i ka sponsorizuar disa libra. Një njeri dashamirës për librin, kulturën dhe bashkëqytetarët e tij.

Diskutuan: Prof. Dr. Lekë Sokoli, President i Institutit Shqiptar të Sociologjisë; Prof. Dr. Ylljet Aliçkaj, Përgjegjës i departamentit të Edukimit dhe Komunikimit në Universitetin "Mesdhetar" të Shqipërisë, shkrimtar, skenarist, ish-ambasador i Shqipërisë në Francë, Asc. Prof. Dr. Shefqet Hoxha, Mësues i Popullit, Mjeshtër i Madh, Nderi i Kombit; Nora Malaj, ish-deputete dhe ish-zëvendësministre e Arsimit, kolege e autorit; Dr. Ilir Aliaj pedagog në Universitetin "Mesdhetar" të Shqipërisë; Ibrahim Hamza, ish-nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë në dy legjislatura; historiani dhe studiuesi Sali Onuzi; Dr. Mark Palnikaj e të tjerë.

Librat e tij trajtojnë probleme të psikologjisë, pedagogjisë, didaktikës, sociologjisë, historisë, etnografisë dhe folklorit.

Bytyçi dhe Kosova zënë një vend të rëndësishëm në kolonën e librave të botuara.

Ai ka treguar kujdes edhe në zgjedhjen e redaktorëve e të recensentëve, ku mund të përmenden: Akademik Mark Tirtën, Hakif Bajramin, Profesorët Lekë Sokoli, Ylljet Aliçka, Bashkim Lusha, Prof. Asc. Dr. Shefqet Hoxha, shkrimtari dhe studi-

uesi Ahmet Qeriqi, publicisti Halil Kata-na, historiani Sali Onuzi, Stavri Kristo, Dr. Ilir Aliaj e Sadri Ramabaja.

Gjithmonë, siç thotë ai, jam konsultuar me ekspertë të fushave të ndryshme në varësi të tematikave. Redaktimi, korrektimi, faqosja të marrin kohë dhe janë shumë të rëndësishme. Në këtë drejtim ka pasur edhe ndihmën e pakursyer të bashkëshortes, e cila është pjesë e botimeve të tij. Ai falënderoi edhe botuesit: Gjon Jaku, Kadri Hyka, Rita Filipi, drejtorin e gazetës "Intervista" Artan Kristo për botimet në kohë, me cilësi dhe çmime favorizuese.

Jetëshkrim i shkurtër e Dr. Skënder Demaliaj

Skënderi ka lindur në Bajram Curr, ku ka marrë edhe edukimin 8 vjeçar dhe atë të mesëm. Më pas ka kryer studimet e larta për Gjuhë - Letërsi, studime pasuniversitare për Psikologji - Pedagogji dhe studimet pasuniversitare për Filozofi.

Është Doktor i Shkencave Psikologjike. Ka punuar drejtues në gjimnazet e Tropojës dhe të Tiranës.

Ka drejtuar kualifikimin e mësuesve në Tropojë dhe në nivel kombëtar.

Ka punuar si pedagog në disa universitete, përgjegjës i departamentit të Shkencave Politike në UMSH.

Ka qene i zgjedhur në pushtetin lokal në rrethin e Tropojës.

Këshilltar i ministres së Integritetit Evropian.

Anëtar themelues dhe i zgjedhur në kryesinë e Bordit të Institutit Shqiptar të Sociologjisë.

Anëtar në Bordin e rekomandimit të Literaturës artistike për shkollat e mesme pranë Ministrisë së Arsimit.

Ekspert për akreditimin në Arsimin e lartë.

Anëtar i Komitetit të Etikës në Ministrinë e Shëndetësisë.

Anëtar i Shoqatës së intelektualëve në Gjakovë.

Ka punuar: me Këshillin Britanik, ekspert për politikën sociale në projektin e Bankës Botërore për remintancat e emigrantëve dhe me fondacione vendase dhe të huaja për problemet e adoleshentëve.

Ka marr pjesë në disa Konferenca Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare dhe ka botuar me qindra artikuj në shtypin shkencor, në shtypin e ditës brenda dhe jashtë vendit.

Botimet:

Ka botuar deri tani 20 libra, monografi dhe studime në fushën e pedagogjisë, didaktikës, psikologjisë, historisë, folklorit, etnografisë, sociologjisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare:

"Masakra e Gjilanit", 1999.

"Figura dhe ngjarje historike", 2001.

"Poem kosovar në pendën e Mitrush Kutel", 2002.

"164 pyetje për dashurinë", 2002.

"Dashuria pret...", 2003.

"Njerëz të mëdhenj: anekdota, fjalë të mençura, kuriozitete", 2003.

"Poezi për gjuhën shqipe", 2005.

"Mësimdhënia e të menduarit në letërsi", 2010.

"Kthimi i shpejtë i shqiptarëve të Kosovës në trojet e tyre mijëvjeçare në verën e vitit 1999", 2020.

"Këndvështrime të reja vizion i ri në punën me adoleshentët", 2021.

"Portrete intelektualësh", 2021.

"Doktrina putiniste dhe Kosova", 2023.

"Mendime, analiza dhe vlerësime për libra", 2023.

"Përmbledhje studimesh Pjesa e parë", 2023.

"Shkrime për Bytyçin", 2023.

"Kanuni i Bjeshtës së Sylbicës", 2023.

"Kur politika behet nga rruga, nuk ka vend për intelektualët", 2024.

Monografi për Shaban Haxhinë, 2024.

Monografi për Fehmi Aganin, 2024.

Studime për Kosovën, 2025.

Planet e tij për të ardhmen janë:

Kolana për adoleshentët, pjesa e dytë dhe e tretë, Kolana për Kosovën dhe Bytyçin, librat Psikoanalizë e historisë së popullit shqiptar, Didaktikë e letërsisë e të tjera.

Nderimet janë:

*Është dekoruar, me Urdhrin "Naim Frashri të Klasit të Tretë" me motivacionin "Për drejtimin dhe organizimin e punës mësimore - edukative në shkollë".

*Është nderuar, me titullin "Ambasador i Paqes".

*Është dekoruar në 10 - Vjetorin e Universitetit "Mesdhetar" të Shqipërisë, për punën e palodhur.

*Është nderuar, me Çmimin e Ekselencës "Fehmi Agani" në shkencën sociale dhe humane nga Komisioni i Vlerësimit të Kontributeve Akademike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Diasporë).

*Është nderuar, me titullin "Qytetar Nderi" me motivacionin "Për kontributin e tij në fushën e arsimit dhe promovimin e vlerave dhe të traditave më të mira kulturore, historike dhe etnopsikologjike në rrethin e Tropojës dhe në krahinën e Bytyçit".

Përgatitur nga

IBRAHIM HAJDARMATAJ

Një denoncim ndërkombëtar i guximshëm ndaj krimeve serbe kundër popullatës në Kosovë

Përhëndetje Prof. Luljeta Pula!

E lexova me shumë vëmendje librin tuaj për helmimin e fëmijëve në Kosovë në vitin 1990, me titullin "Helmimet, Krimi dhe Mashtrimi". Është një punë shumë e madhe dhe me një përkushtim të jashtëzakonshëm, siç keni ditur Ju gjithmonë të punoni në vijën e parë të mbrojtjes së interesave kombëtare të vendit.

Jam mrekulluar me grumbullimin, sistemimin e interpretimin e saktë të provave të panumërta që vërtetojnë helmimin dhe hedhin dritë mbi qëllimet politike të shtetit serb, për ta përdorur situatën që provokuan atëherë në dem të autonomisë së Kosovës. Synimi juaj patriotik është i qartë: ngritja e një padie kundër Serbisë dhe aktualizimi i këtij krimi barbar për të krijuar klimën që do t'i hapë rrugën një padie ndërkombëtare për gjenocid në Kosovë.

Mbledhja e materialeve, nën regjimin e atëhershëm serb, ishte tepër i vështirë, por ju me këmbëngulje të pashoqe ja dolët me shumë sukses. Një mbi 300 faqe të librit ndeshesh kudo me fakte, me dokumente dhe analiza shumë të zgjuara e të

guximshme, që evidentojnë qartë gjenocidin e turpshëm e antinjerëzor që u aplikua kundër fëmijëve të pafajshëm, me qëllim që të provokohej reagimi i prindërve të



tyre e pastaj të ligjërohej ndërhyrja brutale shtetërore. Dhe nuk ishin pak, por 7421 fëmijë shqiptarë.

Ky libër nxjerrë në dritë fakte, i dokumenton ato me shumë kujdes dhe krijon kushte që të ruhen në kujtesën e brezave të ardhshëm për vite të tëra, për t'u kujtuar atyre se deri ku shkon urrejtja nacionale serbe ndaj popullit të paepur kosovar.

Në këtë aspekt ai, është një kontribut i jashtëzakonshëm patriotik që realizohet në kushte mjaft të vështira dhe të rrezikshme për autoren e librit.

E jashtëzakonshme është përballja juaj, e vetme nga Kosova, në debatin "Porota" të TV Beogradit. Edhe pse jo mjeke neuropsikiatere, aty shkëlqen njohja e thelle e juaj shkencore, i cili del qartë jashtë kufijve të një kimisteje, zgjuarsia për të nuhatur situatat dhe për të reaguar me saktësi e shpejtësi, guximi për t'u ndeshur pa asnjë hezitim me atë "tabor të përzgjedhur filoserb", që ishte i pranishëm në emision, kur Ju ishit pa asnjë përkrahje nacionale. Ndërprerjet e drejtuesit të emisionit ishin të shpeshta dhe dinake, por nuk arritën të të bënin të heshtje. Ju e kishit ndarë mend-

jen njëherë e mirë për ta thënë mendimi tuaj që kur u nisët e vetme drejt Beogradit. Dhe libri nuk mbyllet këtu, por vazhdon me dokumentacionin e seleksionuar për t'i hapur rrugë "udhëtimit" të tij drejt Komisionit Ndërkombëtar të Hagës, për Luftën Kimike dhe Biologjike, një mekanizëm i krijuar nga OKB-ja.

Edhe nëse dështojmë, theksohet që në fillim të librit, dënimi e trajtimi i duhur i padisë dhe aktualizimi i këtij krimi barbar në nivel internacional kanë vlerë të pakontestueshme, mbasi "krimi nuk vjetrohët asnjëherë".

Së fundi, mësova me shumë kënaqësi se ditët e fundit doli nga shtypi botimi i këtij libri në Gjuhën Serbe, madje dhe se kopje të tij qarkullojnë brenda në Serbi. Edhe ky është një kontribut i jashtëzakonisht i rëndësishëm e i guximshëm. Por sigurisht është qëndrimi i juaj stoik kombëtar i kahershëm, që e shpërfill çdo lloj rreziku në dobi të popullit të Kosovës martire.

Ju uroj shëndet e jetë të gjatë për të mirën tuaj e të familjes, por edhe të të gjithë shqiptarisë!

Me shumë respekt e mirënjohje!

Prof.dr. VUKSAN KOLA

UMT, Departamenti i Neuroshkencës.
Tiranë, 12. 5. 2025.

Lufta e Dytë Botërore në 80-vjetorin e përfundimit

NGA PASKAL MILO

Në 8-9 maj është 80-vjetori i dorëzimit të ushtrisë naziste gjermane dhe kapitullimi i Gjermanisë hitleriane para forcave të Kombeve të Bashkuara Antifashiste. Kjo ngjarje shënoi përfundimin e Luftës në Evropë, gati pesë vite pasi ajo filloi në 1 shtator 1939 me agresionin gjerman kundër Polonisë.

Ajo pati një rëndësi të jashtëzakonshme për të gjithë popujt antifashistë të botës, sepse u dorëzua dhe u mposht fuqia më e madhe dhe më agresive e Boshtit Fashist.

Përfundimi i Luftës në shkallë botërore ndodhi disa muaj më vonë, në 2 shtator 1945 kur Japonia, vendi tjetër kryesor i Boshtit Fashist u detyrua të ulë armët. Edhe kjo fuqi militariste që në vitin 1931 zbatoi politikën ekspansioniste në Azinë Lindore duke pushtuar territorin kinez të Mançurisë dhe në vitin 1937 filloi luftën e hapur agresive kundër Kinës. Përfundimi i Luftës dhe fitorja mbi Boshtin Fashist ishte fitore e të gjithë popujve antifashistë në të gjithë botën përfshirë edhe popullin shqiptar, ishte triumfi i së mirës, i forcave paqedashëse, i progresit dhe i të ardhmes kundër së keqes, forcave të errëta dhe të holokaustit që donin ta kthenin prapa rrotën e historisë.

Lufta e Dytë Botërore për nga përmasat e saj të shtrirjes mbetet konflikti më i madh në historinë ndërkombëtare. Ajo përfshiu thuajse të gjitha kontinentet, oqeanet e detet, shkaktoi me dhjetëra e dhjetëra miliona njerëz të vrarë e të gjymtuar, shkatërroi me qindra mijëra qendra banimi të mëdha e të vogla, ekonomitë e vendeve të përfshira në luftë, por edhe të vendeve të tjera që ndenjën mënjane saj, u grabitën pasuri të çmuara e të jashtëzakonshme materiale, monetare, artistike, kulturore dhe u përjetuan trauma të pashlyeshme.

Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore u bë i mundur për disa arsye. Rrënjët e saj duhen kërkuar në përfundim të Luftës së Parë Botërore kur në Konferencën e Paqes në Paris, në vitet 1912-1920, shtetet fituese të saj vendosën kushte të rënda penalizuese e kufizuese politike, ekonomike dhe ushtarake ndaj shteteve të mundura si dhe aneksime territoriale. Traktatet e nënshkruara mbollën farën e pakënaqësisë sidomos në Gjermani, e cila me kalimin e viteve u rrit e u zgjerua dhe u shfrytëzua nga qarqe ekstreme të djathta e nacionaliste për të organizuar lëvizje dhe organizata politike me platforma revanshiste. Kështu lindën partitë fashiste në Gjermani, Itali apo vende të tjera, ku në qendër të programeve të tyre u vendosën ideologji raciste, ekspansioniste e luftënxitëse.

Një arsye tjetër ishte se sistemi i ri ndërkombëtar, i njohur ndryshe edhe si sistemi i Versajës, që u inaugurua pas Konferencës së Paqes në Paris së bashku me Lidhjen e Kombeve që u krijua nuk garantuan siç u shpall ruajtjen e paqes e të sigurisë ndërkombëtare. Ato dështuan

të pengonin edhe thyerjen e kufizimeve ushtarake të parashikuara në traktatet për shtetet e mundura, si dhe aktet e para agresive kundër vendeve të tjera, siç ishte pushtimi i Mançurisë nga Japonia në vitin 1931 dhe fillimi i Luftës së Dytë sino-japoneze në 1937, pushtimi i Etiopisë në 1935 dhe i Shqipërisë në 1939 nga Italia fashiste, "bashkimi" me dhunë i Austrisë me Gjermaninë në vitin 1938 dhe pushtimi prej saj të Çekosllovakisë në mars 1939.



Jo vetëm kaq, por fuqitë perëndimore evropiane, Britania e Madhe e Franca si dhe shteti sovjetik, pasi dështuan në përpjekjet e tyre për të krijuar një front antifashist, ndoqën politikën e lëshimeve e të kompromiseve me Gjermaninë naziste për të shmangur gjithsecili rrezikun për vete dhe duke inkurajuar Hitlerin kundër të tjerëve. Të kësaj natyre ishin Marrëveshja e Mynihut e shtatorit 1938 midis Francës e Britanisë së Madhe me Gjermaninë e Italinë, dy nga tri vendet e Boshtit fashist (Berlin – Romë – Tokio) arritur në vitin 1936, e njohur ndryshe si Boshti fashist. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Gjermania lejohej të fuste trupat e saj pushtuese në krahinën e Sudeteve të Çekosllovakisë, ngjarje kjo që gjashtë muaj më vonë përfundoi me pushtimin e gjithë vendit.

Në thelb, edhe qeveria sovjetike bëri të njëjtin veprim. Pas disa muajsh negociatash të fshehta, të shoqëruara edhe me shkëmbime letrash mes Hitlerit e Stalin-it, në gusht 1939 në Moskë u nënshkrua Traktati i fshehtë sovjetiko-gjerman, i njohur ndryshe Traktati Ribentrop - Molotov. Ky traktat i arritur në sekret të plotë disa ditë para agresionit nazist kundër Polonisë i hapi përfundimisht dritën jeshile pushtimit të këtij vendi, ndarjen territoriale të tij dhe të zonave të influencës në shtete të tjera rreth tij.

Pushtimi i Polonisë dhe hyrja në luftë e Britanisë së Madhe dhe e Francës kundër Gjermanisë së Hitlerit shënoi fillimin "zyrtar" të Luftës së Dytë Botërore në Evropë. Pas disa muajsh parapërgatitjesh intensive, në pranverën e vitit 1940, ushtria naziste sulmoi në front të gjerë vendet

perëndimore: në prill Danimarkën dhe Norvegjinë, në maj Belgjikën, Holandën, Luksemburgun dhe Francën. Këto vende u pushtuan shpejt pa përjashtuar edhe Francën, një fuqi e madhe evropiane, që kapitulloi pas një muaji luftimesh. Hitleri synoi edhe pushtimin e Britanisë së Madhe, por nuk arriti të kontrollonte hapësirën ajrore mbi Kanalin e La Mansh-it dhe filloi një fushatë masive bombardimesh ajrore në korrik-tetor 1940 kundër infrastrukturës ushtarake, qendrave industriale dhe qyteteve britanike, veçanërisht ndaj Londrës. Britanikët rezistuan dhe i shkaktovan humbje të mëdha Luftwaffe (forcave ajrore gjermane), fakt ky që nxiti ndjenjën e rezistencës kombëtare dhe shënoi kthesën e parë të madhe të Luftës.

Gjermania naziste kishte objektiva të mëdha pushtuese edhe në lindje të Evropës. Ndonëse ajo kishte nënshkruar në gusht 1939 një traktat mossulmimi me Bashkimin Sovjetik, Hitleri përgatiti Operacionin "Barbarossa" për të pushtuar atë. Por para se të vepronte, synoi të siguronte krahun jugor të sulmit. Ai arriti t'u imponojë Bullgarisë, Rumanisë e Hungarisë përmes premtimeve territoriale bashkimin me Boshtin fashist. Ndërkohë që për shkak të dështimeve të Italisë për të pushtuar Greqinë në një luftë që zgjati gati gjashtë muaj (tetor 1940 – prill 1941) dhe të një grushti shteti që ndodhi në Beograd në 27 mars 1941, që pengoi Jugosllavinë të bëhej anëtare e Boshtit fashist, Hitleri urdhëroi ushtrinë gjermane të ndërhynte dhe t'i pushtonte këto dy vende brenda muajit prill 1941.

Në 22 qershor, 1941 ushtria naziste e sulmoi Bashkimin Sovjetik në tri drejtime kryesore strategjike: në veri për të pushtuar vendet baltike dhe qytetin e Leningradit (Shën Petërburgu), në qendër me synimin për pushtimin e kryeqytetit sovjetik, Moskën dhe në jug për të pushtuar Ukrainën, kryeqytetin e saj Kievin, të pasur me grurë e qymyr. Hitleri shpresoi se do ta mposhte shtetin sovjetik para ardhjes së dimrit. Por ushtria gjermane me gjithë sukseset e para të saj dështoi në arrijtjen e objektivave kryesore për disa arsye: për shkak të qëndrës së madhe të popullit e të ushtrisë sovjetike, për shkak të nënvlerësimit të forcës sovjetike, për shkak të vështirësive logjistike që pengoi furnizimin në kohën dhe sasinë e duhur të trupave gjermane, për shkak të dimrit të ashpër rus dhe të mospërballimit të tij, por edhe për shkak të ndihmës amerikano-britanike ("Lend-Lease") në armë, makina, materiale industriale dhe ushqime. Ushtria naziste u ndalua në pragun e Moskës dhe gradualisht duke filluar nga fundi i vitit 1942 iniciativa në fushën e luftimeve kaloi në anën sovjetike.

Pushtimi i vendeve të Evropës Qendrore, Juglindore e Perëndimore të Evropës si dhe agresioni gjerman në lindje kundër Bashkimit Sovjetik i shoqëruar me operacione luftarake në Oqeanin Atlantik u kuptua në Shtetet e Bashkuara të

Amerikës edhe si një kërcënim për interesat e tyre të sigurisë e më gjerë. Për të ndaluar këtë rrezik madhor e për të krijuar një front botëror antifashist, në 14 gusht 1941 Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Franklin Delano Roosevelt u takua me kryeministrin e Britanisë së Madhe, Winston Churchill në Newfoundland (Toka e re) në Oqeanin Atlantik në përfundim të të cilit u nënshkrua një Deklaratë, e njohur ndryshe si "Karta e Atlantikut". Deklarata përbëhej nga tetë parime në emër të të cilave Roosevelt dhe Churchill u kërkuan të gjitha kombeve antifashiste që të bashkoheshin me të. Kjo Deklaratë u bë objekt i një konference ndërkombëtare në Washington DC në 1 janar 1942, u miratua nga përfaqësues të 26 kombeve, midis të cilëve ishte edhe ai kinez. Dokumenti u njoh me emrin "Deklarata e Kombeve të Bashkuara" dhe shënoi themelimin zyrtar të koalicioneve të emërtuar Kombet e Bashkuara Antifashiste. Nënshkruarit e kësaj Deklarate u angazhuan që të mobilizonin në shërbim të luftës kundër anëtarëve të paktit trepalësh fashist (Gjermani-Itali-Japoni) të gjitha burimet e tyre ushtarake ose ekonomike, të bashkëpunonin midis tyre dhe të mos përfundonin me armikun as armëpushim, as edhe paqe të veçantë.

Ndërkohë që bëheshin përgatitjet për nënshkrimin e kësaj Deklarate, në 7 dhjetor 1941, forcat ajrore ushtarake japoneze sulmuan bazën detare amerikane në Hawaii, duke shkaktoar dëme të mëdha në anije e avionë amerikanë, ku edhe u vranë 2400 ushtarakë e civilë amerikanë. Ky sulm shënoi një kthesë tjetër të rëndësishme në zhvillimin e Luftës së Dytë Botërore. Shtetet e Bashkuara që deri atëherë kishin qëndruar në një farë mënyre neutrale në luftë, një ditë më vonë, në 8 dhjetor u shpallën luftë Japonisë. Me këtë veprim ato hynë zyrtarisht në Luftën e Dytë Botërore, në fillim kundër Japonisë e më pas kundër Gjermanisë e Italisë.

Me hyrjen e Shteteve të Bashkuara lufta mori karakter të përbotshëm. Zjarri i saj përfshiu të gjitha kontinentet dhe oqeanet. Në frontet e mëdha të kësaj lufte u zhvilluan beteja të përmasave të panjohura e të paimagjinuara më parë mes palëve ndërluftuese, me humbje katastrofike njerëzore e materiale. Ata janë shumë e në pamundësi për t'i përmendur të gjitha, vlejnjë të veçohen ato më kryesoret dhe që përcaktuan tendencën e zhvillimit të përfundimit të Luftës dhe që kontribuan në fitoren e Kombeve të Bashkuara e në disfatën e fuqive të Boshtit fashist.

Në pikëpamje të rendit kronologjik mund të përmenden sot në 80-vjetorin e fitores kundër fashizmit, beteja e Moskës (tetor 1941-janar 1942) ushtria sovjetike ndaloi pushtimin e kryeqytetit, shtyu trupat gjermane dhe shënoi fitoren e parë të madhe kundër ushtrisë naziste, duke dëshmuar se ajo nuk ishte e pathyeshme, beteja detare në ishullin Midway (4-7 qershor 1942) në Paqësorin Verior që njihet si një nga betejat më të rëndësishme de-

tare në histori dhe në të cilën amerikane të shkatërruan katër aeroplanmbajtëse japoneze; betejat e El Alameinit në Afrikën Veriore në gjysmën e dytë të vitit 1942, kur forcat britanike përballuan forcat e bashkuara gjermano-italiane për të pushtuar Kanalin e Suezit, duke i detyruar ato të tërhiqeshin gradualisht. Humbja e El Alamenit shënoi fillimin e fundit të pranisë gjermano-italiane në Afrikë dhe ndryshoi ekuilibrin strategjik në rajonin e Mesdheut në favor të Kombeve të Bashkuara antifashiste; beteja e Stalingradit (17 korrik 1942 – 2 shkurt 1943) ishte dështimi i parë i madh gjerman në Frontin lindor, u rrethua dhe u dorëzua ushtria e 6-të gjermane me në krye komandantin e saj, Friedrich Paulus, që u konsiderua si një goditje e rëndë morale për Gjermaninë naziste dhe kthesë strategjike në favor të ushtrisë sovjetike e të luftës antifashiste; beteja e Kurskut (5 korrik–23 gusht 1943) ishte beteja më e madhe e tankeve në histori, me rreth 6 mijë tanke dhe me më shumë se 2 milionë ushtarë. Kjo betejë përfundoi me fitoren e ushtrisë sovjetike dhe shënoi kalimin e iniciativës strategjike në duart e saj; zbarkimi i forcave aleate britanikoamerikane në Sicili dhe Itali në (korrik–gusht 1943) dhe dorëzimi i Italisë fashiste në 8 shtator 1943. Kjo ngjarje ndikoi në shpejtimin e fundit të Luftës në Evropë dhe në dobësimin e mbrojtjes gjermane në kontinent; zbarkimi Aleat (D – Day) në Normandi në 6 qershor 1944 shënoi hapjen e frontit të dytë të luftimeve në Evropë dhe operacionin më të madh amfib në histori me mbi 15 mijë trupa amerikane, britanike dhe kanadeze. Me këtë zbarkim filloi gradualisht çlirimi i Francës dhe i Evropës Perëndimore, u dobësua fuqia ushtarake gjermane dhe u hap rruga që Aleatët të avanconin drejt Berlinit; beteja e Okinawa-s në Japoninë Jugore (1 prill–22 qershor 1945). Kjo ka qenë beteja më e madhe amfibe në frontin e Paqësorit, pati rreth 200 mijë viktima, ushtarakë e civilë dhe shërbeu si parapërgatitje për pushtimin e Japonisë; operacionet aleate, sovjetike e perëndimore për çlirimin e Berlinit (prill – maj 1945), që çuan përfundimisht në nënshkrimin e aktit të kapitullimit të Gjermanisë në 8 maj 1945. Rënia e Berlinit shënoi edhe përfundimin e Luftës së Dytë Botërore në Europë; hedhja e bombave atomike amerikane mbi qytetet japoneze Hiroshima dhe Nagasaki në gusht 1945 dhe pas kësaj, hyrja e Bashkimit Sovjetik në luftën kundër Japonisë militariste çoi në nënshkrimin e aktit të kapitullimit të saj në 2 shtator 1945. Kjo datë është edhe fundi i Luftës së Dytë Botërore.

Pjesa e rëndësishme përbërëse e Luftës së Dytë Botërore kanë qenë edhe luftimet në Azinë Lindore e në veçanti ato në Kinë, kundër Japonisë militariste. Si një Fuqi kryesore e Boshtit fashist, Japonia nisur nga objektivat e saj ekspansioniste imerialiste në Azi që në vitin 1937 filloi pushtimin e Kinës Qendrore e Jugore, ndërsa pas sulmit në Pearl Harbor, në dhjetor 1941, pushtoi vende të tjera aziatike si Filipinet, Indokinën, Birmaninë (Mayanmar) dhe Indonezinë. Popujt e këtyre vendeve u rezistuan me armë militaristëve pushtues japonezë, veçanërisht në Filipine, Birmani e Vietnam. Në shumicën e vendeve të Azisë Lindore rezistenca antifashiste nuk ishte vetëm e armatosur, por me forma e mënyra të ndryshme, gjithëpërfshirëse.



Një nga frontet më të mëdha të Luftës së Dytë Botërore në Azi ishte Kina. Ajo luajti një rol të rëndësishëm në rezistencën dhe luftën kundër Japonisë militariste. Agresioni japonez kundër Kinës filloi që në korrik 1937, mbi dy vite para se të shpërthente në nivel global Lufta e Dytë Botërore me sulmin e Gjermanisë naziste kundër Polonisë. Duke u mbështetur në këtë referencë historike mjaft historianë e cilësojnë nisjen e Luftës së Dytë sino – japoneze në korrik 1937 si fillimin e Luftës së Dytë Botërore, duke pasur parasysh se Japonia në këtë kohë ishte zyrtarisht anëtare e Boshtit fashist. Në frontin kinez Japonia hodhi mbi një milion ushtarë, ndërkohë që Kina mobilizoi kundër saj rreth 700 mijë forca. Midis dy ushtrive janë zhvilluar beteja të mëdha si ajo e Shangait në 1937 e që zgjati tre muaj dhe shumë ishuj të Oqeanit Paqësor, beteja e Changsha në provincën Hunan, që u zhvillua në tri faza (1939 – 1942), fushata e Birmanisë (1942 – 1945) në të cilën rreth 100 mijë ushtarë kinezë nën komandën amerikane u angazhuan në luftime kundër trupave japoneze. Këto forca kineze që morën pjesë në këto luftime u mobilizuan nga qeveria nacionaliste e Guomindangut që qeveriste vendin në këtë kohë.

Një rol të madh në luftën kundër pushtimit japonez në Kinë ka luajtur Partia Komuniste e Kinës dhe forcat e saj të ar-

matosura nën udhëheqjen e Mao Zedong. Pas “Marshimit të Gjatë” (1934 – 1935) PKK zgjeroi influencën dhe kontrollin e saj në zonat rurale në veri e në qendër të Kinës, të pushtuara nga japonezët. Ajo ngriti një rrjet të gjerë zonash të çliuara rurale të njohur me emrin “Zona të Bazës Antijaponeze”, ku u ndërtuan struktura lokale të vetëqeverisjes dhe u organizuan reforma sociale. Forcat kryesore të armatosura të PKK ishin Ushtria e 8-të Rrugo-

rekt në Konferencat e SHBA – Britanisë – Bashkimit Sovjetik në Teheran (dhjetor 1942 – janar 1943), në Jaltë (shkurt 1945) e Potsdam (korrik – gusht 1945), statusi i saj si Fuqi Aleate u njoh dhe u fiksua në dokumentet e prodhuara aty.

Lufta e Dytë Botërore si një ngjarje e madhe historike ka dhënë dhe jep mësim të çmuara për brezat njerëzorë që kanë kaluar, për ata të sotëm e të së ardhmes. Ajo rikujton e bën thirrje për vigjilencë, për të mos toleruar akte të rrezikshme e kompromise në dëm të popujve e të vendeve të veçanta në emër të interesave të përkohshme. Paqja dhe siguria afatgjatë ndërkombëtare sot mund të garantohet vetëm me qëndrime e veprime kolektive të koordinuara brenda një sistemi ndërkombëtar të rimëkëmbur mbi baza multilateraliste. Bota sot përballlet me sfida të panjohura më parë, të cilat janë globale, por edhe rajonale, të cilat mund të shmangen e të zgjidhen vetëm me dialog, mirëkuptim, vullnet politik e jo me forcën e armëve. Vendimmarrjet e jashtëzakonshme të Fuqive të Mëdha Antifashiste në kohën e Luftës së Dytë Botërore për nga shkalla e përgjegjësisë me të cilat u realizuan edhe sot mund të shërbejnë si model për bashkëpunim të aktorëve kryesorë ndërkombëtarë për të gjetur zgjidhjet më të përshtatshme për sfidat aktuale globale e për qëndrueshmërinë e paqes e të sigurisë ndërkombëtare.

Një nga mësimet kryesore që vjen nga Lufta e Dytë Botërore është kundërshtimi me forcë e në mënyrë aktive i ideologjive dhe qeverisjeve totalitare, i pikëpamjeve ekstremiste, nacionaliste, raciste, i ksenofobisë si instrumente për të kapur pushtetin. Bota sot nuk duhet të bëjë po të njëjtat gabime që u bënë në vitet ‘20-‘30- të të shekullit të kaluar, që toleruan idetë dhe veprimtaritë në rritje të grupeve e partive fashiste, naziste e militariste.

Lufta e Dytë Botërore ka lënë gjurmë të pashlyeshme në memorien kolektive të kombeve. Zëvendësimi i brezave njerëzorë, distancimi kohor nga vetë ngjarja, natyrshëm ka tendencë të zbeh vetë ngjarjen, por mbi të gjitha përgjegjësitë e atyre që përgatitën Luftën, që shkakton dramën më të madhe në historinë e njerëzimit, holokaustin, që mbollën tmerre apokaliptike e që ende shfaqen gjurmët e krimeve e të traumave mizore. Që e keqja të mos përsëritet e për më tepër të mos shumëfishohet është domosdoshmëri që sot e në të ardhmen të vazhdojë përballja kritike me Luftën e Dytë Botërore, që brezat e rinj përmes edukimit historik të ushqehen me njohuri objektive, të respektojnë e të vlerësojnë kontributet në mbrojtje të lirisë, të progresit dhe të identitetit kombëtar. Kujtesa duhet të shërbejë si një moment reflektimi dhe si një busull morale për një të ardhme më të drejtë, paqësore dhe të qëndrueshme për të gjitha kombet.

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSUAN BOTIMIN
VËLLEZËRIT, ZEF,
KRISTJAN E KLAUDIO
PALI, ME BANIM NE
KOMUNEN CUNEO,
ITALI**

